



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA

MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

Plani Strategjik i Sistemit Këshillues të Kosovës për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2023-2027



Shërbimi Këshillimor Bujqësor Rural i Kosovës

Kosovo Agriculture and Rural Development Advisory Services

Poljoprivredna Ruralna Savetodavna Služba Kosova



SIRED

Sustainable and Inclusive
Rural Economic Development

CARITAS

Schweiz
Suisse
Svizzera
Svizra

With funding from



Austrian
Development
Cooperation

REPUBLIKA E KOSOVËS

**MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË
DHE ZHVILLIMIT**

RURAL

**Plani Strategjik i Sistemit Këshillues
të Kosovës për Bujqësi dhe Zhvillim Rural**

2023-2027

MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Rruga Nënë Terezë n.35,

10000 Prishtinë ,

Kosovë.

www.mbpzhr-ks.net

INSTITUCIONET KONTRIBUESE

Në përgatitjen e këtij plani strategjik morën pjesë dhe kontribuan nga fusha e tyre e ekspertizës disa institucione nga sektori publik dhe privat. Grupi i palëve të interesuara përfshinë zyrtarë të MBPZHR, përfaqësues të fermerëve, Kabineti i Ministrisë së Bujqësisë, Fakulteti i Bujqësisë, IBK, AUV, APK, Qendra Informativë Këshilluese Komunale (QIKK), akterë të tregut dhe organizata biznesi.

PUBLIKUAR NGA

Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Rr. Ukshin Hoti - Kompleksi 'Ramiz Sadiku'

10000 Prishtinë, Kosovë

Mars 2023

Prishtinë

MOHIM PËRGJEGJËSIE

Ky publikim është përgatitur në kuadër të projekti “Zhvillimi Ekonomik Rural i Qëndrueshëm dhe Gjithëpërfshirës” (SIREN), në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë së Kosovës, i zbatuar nga Caritas-i Zviceran dhe i mbështetur nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), njësi operative e Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim. Përmbytja dhe qëndrimet e shprehura nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e ADA, ose të Caritas-it Zviceran.

Përmbajtja

1	Hyrje	6
2	Metodologjia	8
3	Konteksti dhe situata aktuale	9
3.1	Analiza SWOT	9
3.2	Shërbimet këshilluese publike	12
3.3	Ofruesit privatë të shërbimeve këshilluese	14
3.4	Certifikimi i këshilltarëve	15
4	Plani Strategjik për Shërbimet Këshillues në Kosovë	18
4.1	Grupet e synuara	18
4.2	Vizioni	18
4.3	Misioni	18
4.4	Objektivat	19
4.5	Riorganizimi	20
4.5.1	Monitorimi & Vlerësimi	25
5	Plani i Veprimit 2023 – 2027	28
5.1	Plani i veprimit në formë të matricës SMART dhe buxheti paraprak	28
5.2	Buxheti i përgjithshëm indikativ për DSHKT-në	32
5.3	Hapat e zbatimit dhe rreziqet e përfshira	32
6	SNJIB - një këndvështrim	33
7	Literatura e konsultuar	35
8	Shtojca - Anëtarët e Grupit Punues	36
9	Stojca – Organogrami i MBPZHR-së	37
10	Shtojca – Vërejtjet për Strategjinë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022 – 2022	38
11	Shtojca - Përvoja nga vende të tjera	43
11.1	Forumi Evropian për Shërbimet Këshillimore në Bujqësi dhe Zhvillim Rural	43
11.2	Austria	43
11.3	Sllovenia	48
11.4	Hungaria	53
12	Shtojca – Rekomandimet për aktivitete të mëtejshme të donatorëve	56
12.1	Përgatitja për SNJIB-në e ardhshëm	56
12.2	Trajnimi efikas për këshilltarët privat që synojnë të punojnë për DSHKT-në	56
12.3	Menaxhimi i tokës dhe bujqësia e qëndrueshme dhe trajnimi specifik përkatës	56
12.4	Mjedisi dhe toka bujqësore: bilanci i azotit	56
12.5	Digjitalizimi në bujqësi dhe trajnimet specifike përkatëse	57

Akronimet¹

ADC	Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim
SNJIB	Sistemi i Njohurive dhe Inovacionit në Bujqësisë
PZHBR	Plani i Zhvillimit Bujqësor dhe Rural
CACH	Caritasi Zviceran
CECRA	Certifikata e Konsulentëve Evropianë në Zonat Rurale
DSHKT	Departamenti i Shërbimeve Këshilluese dhe Teknike
BE	Bashkimi Evropian
EUFRAS	Forumi Evropian për Shërbimet Këshillimore në Bujqësi dhe Zhvillim Rural
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
SKKBZHR	Sistemi Këshillues i Kosovës për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
LW	Landwirtschaftskammer (Oda Austriake e Bujqësisë)
MBPZHR	Drejtor i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
BMA	Bimë Medicinale dhe Aromatike
QIKK	Qendra Informative Këshilluese Komunale
NAK	Oda Hungareze e Bujqësisë
OJQ	Organizata Joqeveritare
JPDP	Jo produkt drusor pyjor
OSzK	Qendra Këshilluese Kombëtare Hungareze
SHKR	Shërbimet Këshilluese Rurale
SSHKBZHR	Strategjia e Shërbimit Këshillues për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
FSHKM	Forcimi i Shërbimeve Këshilluese dhe Mbështetëse
ZHERQGJ	Zhvillimi Ekonomik Rural i Qëndrueshëm dhe Gjithëpërfshirës
VNT	Vlerësimi i Nevojave për Trajnim
TeR	Termet e Referencës
TiT	Trajnimi i Trajnerëve
AAP	Arsimi dhe Aftësimi Profesional
GP	Grupi Punues

¹ Ka disa mënyra për akronimet; për këtë raport është përdorur Strategjia zyrtare për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022 – 2028 në versionin në gjuhën angleze në lidhje me akronimet.

1 Hyrje

Sektori i shërbimeve këshilluese është themeluar në kuadër të departamentit për zhvillimi rural të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) në vitin 2003, me synim zgjerimin e rrjetit dhe rritjen e kapaciteteve të shërbimeve këshilluese në formë institucionale dhe të përhershme.

Bazuar në rregulloren (QRK) Nr. 37/2013 për organizmin e mbrendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në MBPZHR, dhe me Ligjin Nr.04/L-074 për shërbimet këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural, sektori i shërbimeve këshilluese u organizua si shërbim publik dhe privat.

Plani Strategjik i Sistemit Këshillimor të Kosovës për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2023-2027 synon përmirësimin e sektorit të bujqësisë në Kosovë, si dhe rritjen e produktivitetit, përpunimit dhe marketingut bujqësor. Ky plan strategjik përcakton qëllimet dhe prioritetet afatgjata të politikës për zhvillimin e shërbimeve këshilluese, si dhe lehtëson zbatimin e politikave sektoriale për zhvillimin e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural, i cili përmban objektiva të qarta, parashikon zbatimin e veprimeve dhe funksionimin e të gjithë mekanizmave që mundësojnë arritjen e këtyre prioritetëve në fushën e zhvillimit të sistemit këshillues bujqësor dhe zhvillimit rural.

Me qëllim të përmirësimit të sektorit bujqësor të Kosovës, si dhe të rritjes së produktivitetit, përpunimit dhe marketingut bujqësor, konsulenti është kontraktuar për të mbështetur Grupin Punues (GP) të MBPZHR-së me më shumë se 17 anëtarë për hartimin dhe validimin e strategjisë këshillëdhënëse. Janë organizuar shumë takime zyrtare të GP-së dhe gjithashtu takime me palët e interesit në grupe më të vogla. Mbështetësin fermerët për të rritur prodhimin, produktivitetin dhe diversifikimin e burimeve të gjenerimit të të ardhurave. Për të siguruar qëndrueshmërinë afatgjatë teknike dhe financiare të shërbimeve këshilluese dhe mbështetëse në Kosovë, ato duhet të dizajnohen dhe menaxhohen duke pasur parasysh parimet e mëposhtme të praktikave më të mira:

- Shërbimet duhet të jenë të drejtuara nga kërkesa dhe të përgjegjshme ndaj palëve të interesit ku përdoruesit fundorë përfshihen në procesin e menaxhimit.
- Marrëdhëniet e punës efektive dhe praktike duhet të krijohen me furnizuesit partnerë të shërbimeve duke përfshirë agjencitë e tjera qeveritare (komunat), OJQ-të, konsulentët e sektorit privat, organizatat mbështetëse bujqësore duke përfshirë bankat, “akademinë/institucionet kërkimore” veçanërisht institutin në Pejë, Departamentin e Analizave Ekonomike, AUV-në dhe projektet përkatëse të financuara nga donatorët.
- Qeveria duhet të veprojë si nxites dhe lehtësues për zhvillimin rural, duke mbështetur sektorin privat, i cili do të jetë shtytës i zhvillimit rural në Kosovë. Si të tilla, Shërbimet Këshilluese dhe Mbështetëse të sektorit publik duhet të ndikojnë në rritjen e tregut të sektorit privat për kërkesë dhe ofrimin e shërbimeve.
- Duhet të ketë ndërveprim të fuqishëm ndërmjet shërbimeve këshilluese, departamenteve teknike të MBPZHR-së dhe institucioneve kërkimore dhe trajnuese.
- Shërbimet këshilluese dhe mbështetëse duhet të maksimizojnë avantazhin krahasues të organizatave të përfshira.
- Efikasiteti ekonomik - përfitimet duhet të justifikojnë kostot e shërbimeve.
- Qasjet pjesëmarrëse duhet të përdoren sipas rastit.
- Aktivitetet duhet të ndërmerren dhe menaxhohen në nivelin më të afërt me klientin që ka aftësinë dhe burimet për ta bërë këtë në një mënyrë me kosto efektive.
- Duhet të krijohet një rindarje e qartë e kostove (ndarja e koston) dhe një përzierje optimale e mekanizmave të financimit dhe ofrimit të shërbimeve.

- Praktikrat më të mira bujqësore duhet të përsëriten.
- Monitorimi dhe vlerësimi duhet të jetë një proces i vazhdueshëm.

Ligjet aktuale lidhur me planin strategjik

Ligji për Shërbimet Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural nr. 04/L-074 (GZ. nr. 04/19 mars 2012), ka hyrë në fuqi në vitin 2012 dhe është plotësuar me të gjitha aktet nënligjore për zbatimin e tij.

Qëllimi i ligjit

- 1) Ky ligj rregullon organizimin dhe zbatimin e aktiviteteve të shërbimeve këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural, marrëdhëniet ndërmjet palëve të interesit me qëllim të zhvillimit të bujqësisë dhe zhvillimit rural në Republikën e Kosovës.
- 2) Ngritja e nivelit të përgjithshëm të njohurive të fermerëve, trajnimi i tyre për të menaxhuar fermën, rritja e të ardhurave të fermës, mbështetja në zgjidhjen e problemeve që lidhen me prodhimin, çështjet ekonomike dhe organizative për zhvillimin e fermës, ruajtja e 2 burimeve natyrore, mjedisore, gjurmimi i arritjeve dhe tendencave në BE, bazuar në kërkesat e tregut.

Ligje të tjera që kanë të bëjnë me Planin Strategjik të SKKBZHR-së

- Ligji Nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, (Gazeta Zyrtare Nr. 56/27 korrik 2009);
- Ligji Nr. 04/L-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/16 tetor 2012)
- Ligji Nr. 2003/3 për Pyjet e Kosovës (Gazeta Zyrtare Nr. 34/01 gusht 2008)
- Ligji Nr. 03/L-029 Inspektionin Bujqësor, (Gazeta Zyrtare Nr. 45/12 janar 2009);
- Ligji Nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore, (Gazeta Zyrtare Nr. 13/01 qershor 2007);
- Ligji Nr. 02/L-9 për Ujitjen e Tokave Bujqësore, (Gazeta Zyrtare Nr. 11/01 prill 2007);
- Ligji Nr. 03/L-198 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-9 për Ujitjen e Tokave Bujqësore, (Gazeta Zyrtare Nr. 77/16 gusht 2010);
- Ligji Nr. 2004/13 për Materialin Fidanor, (Gazeta Zyrtare Nr. 22/01 mars 2008);
- Ligji Nr. 2003/5 për Farërat, (Gazeta Zyrtare nr. 8/15 dhjetor 2006);
- Ligji Nr. 2004/21 për Veterinarinë, (Gazeta Zyrtare Nr. 18/01 nëntor 2007);
- Ligji Nr. 04/L-191 për Blegtorinë, (Gazeta Zyrtare Nr. 25/08 korrik 2013);
- Ligji Nr. 02/L-10 për Kujdesin ndaj Kafshëve, (Gazeta Zyrtare Nr. 5/01 tetor 2006);
- Ligji Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor, (Gazeta Zyrtare Nr. 83/29 tetor 2010);
- Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, (Gazeta Zyrtare Nr. 50/06 prill 2009);
- Ligji Nr. 08/L-120 për Ushqimin, (Gazeta Zyrtare Nr. 23/12 gusht 2022)
- Ligji Nr. 04/L-085 për Bujqësinë Organike, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/16 tetor 2012);
- Ligji Nr. 02/L-111 për Bletari, (Gazeta Zyrtare Nr. 35/15 gusht 2008)
- Ligji Nr. 02/L-8 për Verërat, (Gazeta Zyrtare Nr. 9/01 shkurt 2007)
- Ligji Nr. 04/L-019 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-8 për Verërat (Gazeta Zyrtar Nr. 13/01 shtator 2011).
- Ligji Nr. 06/L-034 për mbrojtjen e konsumatorit (Gazeta zyrtare nr. 11 / 14 Qershor 2018)

2 Metodologjia

Metodologjia e përgatitjes së Planit Strategjik të Sistemit Keshillues të Kosovës për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (PSSKKBZHR) 2023-2027, teksti në vazhdim plani strategjik.

Plani strategjik është hartuar nga Grupi Punues (GP) me mbështetjen e ekspertëve të angazhuar nga Caritas-i Zvicëran në kuadër të programit “Zhvillimi i Qëndrueshëm dhe Gjithëpërfshirës Ekonomik Rural (SIREN)”. Gjatë procesit të hartimit të këtij dokumenti u përdorën praktikatat e disa vendeve evropiane: Hungarisë, Sllovenisë, Austrisë, të cilat i janë bashkangjitur këtij dokumenti si shtojca.

Për të inkorporuar përvojën nga vendet e tjera të BE-së, praktikatat më të mira nga shtetet individuale anëtare të BE-së siç është Austria janë përfshirë nga konsulentët. Kjo qasje ua mundëson të gjithëve të mësojnë nga përvojat e vendeve të tjera.

3 Konteksti dhe situata aktuale

Palët e interesit në shërbimet këshilluese dhe mbështetëse

Fermerët në mënyrë korrekte i shohin shërbimet këshilluese dhe mbështetëse si një formë efikase për të ndihmuar në përmirësimin e njohurive, efikasitetit, efektivitetit, produktivitetit, përfitimit dhe kontributit për të mirën e familjes dhe komunitetit. Planifikuesit dhe politikëbërësit i shohin shërbimet këshilluese dhe mbështetëse si një instrument politikash për të rritur prodhimin bujqësor, për të arritur sigurinë kombëtare të ushqimit dhe, në të njëjtën kohë, për të ndihmuar në zbutjen e papunësisë dhe varfërisë në zonat rurale. Përveç kësaj, disa ekonomistë i shohin shërbimet këshilluese dhe mbështetëse si një instrument politikash që do të kontribuojë në zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe rritjen ekonomike, dhe për këtë arsye, burimet e ndara për shërbimet këshilluese shihen si investim ekonomik, i cili duhet të prodhojë kthime konkurruese ekonomike.

Zhvillimi bujqësor dhe rural nuk është më çështje vetëm e rritjes së prodhimit të ushqimit dhe bujqësisë; faktorë të tjerë duhet të trajtohen nga politikëbërësit dhe agjencitë e shërbimeve mbështetëse në formulimin dhe zbatimin e politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural. Këto çështje përfshijnë shqetësimet lidhur me popullsinë dhe mjedisin, implikimet e tyre të fuqishme për mënyrën se si duhet të organizohen dhe financohen shërbimet mbështetëse: si kërkimi, edukimi rural, shërbimet këshilluese dhe mbështetëse.

Rritja e popullsisë nënkupton rritje të kërkesës për ushqim, si dhe më shumë presion mbi tokat e brishta dhe marginale, rritje të fragmentimit të tokës dhe një numër më të madh të njerëzve pa tokë në zonat rurale. Presioni i popullsisë dhe kërkesa në rritje për ushqim zakonisht shoqërohen me degradimin e tokës dhe ndotjen e tokës, ujit dhe burimeve të tjera natyrore. Prandaj, shërbimet këshilluese kanë rol vendimtar për të luajtur në përhapjen e teknologjisë së qëndrueshme bujqësore.

3.1 Analiza SWOT

Tema	Përparësitë - Faktorët e brendshëm	Mangësitë - Faktorët e brendshëm
Kapitali njerëzor/stafi	Stafi me përvojë, i arsimuar dhe profesional me përvojë pune shumëvjeçare	Nevoja për më shumë koordinim brenda MBPZHR-së
		Numri i ulët i burimeve njerëzore/punonjësve në DSHKT/QIKK
		Shumë pak konsulente femra
		Vështirësitë në rekrutimin e personelit të ri
Aftësitë	Shumica e aftësive bujqësore në dispozicion	TIK-u nuk është në dispozicion, e përfundimisht as digjitalizimi në bujqësi
	Njohuritë e mira të kushteve në terren nga këshilltarët komunal për bujqësi dhe zhvillim rural	.

Certifikata e Konsulentëve Evropianë në Zonat Rurale	Këshilltarët komunal për bujqësi janë të certifikuar (por jo drejtorët e Drejtoratit të Bujqësisë në komuna, si të emëruar politik)	Stafi i DSHKT-së nuk është i certifikuar pasi që nuk është i përfshirë në këshillim. Këshilltarë komunal dhe të tjerët të certifikuar, por më shumë në aspektin pedagogjik se sa në teknik
Certifikimi i palëve të interesit nga sektori privat	Kompanitë e licencuara për ofrimin e shërbimeve këshilluese	.
Certifikimi CECRA		Nuk është në zbatim
Zyra		Hapësirë e kufizuar brenda MBPZHR-së, pa sallë për takime
Logjistika dhe veturat	Parimisht të disponueshme dhe të buxhetuara	Mungesa e logjistikës, pra veturave për të bërë vizita të papritura në terren
Pajisjet elektronike	Këshilltarët komunal janë të pajisur me kompjuterë dhe disa pajisje për të lehtësuar aktivitetet në terren	Mungesa e laptopëve dhe pajisjeve të tjera
Buxheti	500.000 euro në dispozicion për aktivitete të ndryshme mbështetëse si lehtësimi i inputeve nga shoqatat, konsulentët privat, etj.	Buxheti i pamjaftueshëm
Strategjia e re këshilluese	Më shumë i orientuar nga klienti, bazuar në vlerësimet e nevojave	.
Struktura organizative		Këshilltarët shpenzojnë më shumë se 80% të kohës së tyre të punës duke u marrë me punë jo këshilluese, të cilat kanë të bëjnë me realizimin e detyrave tjera administrative të njësive të tjera në MBPZHR, ndërsa këshilltarët komunal në 90% të kohës së tyre të punës merren me aktivitete administrative të komunave.
Korniza ligjore	Ekzistenca e legjislacionit përkatës	Zbatimi i kufizuar i Ligji për Shërbimet Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
Bashkëpunimi publik dhe privat	Potenciali për të lehtësuar shërbimet	Kuptimi i kufizuar (i bashkëpunimit me sektorin privat)
	Ekzistenca e shoqatave të prodhuesve (të interesuara për të bashkëpunuar)	.
Monitorimit & Vlerësimit	Këshilltarët komunalë raportojnë në Departamentin e Shërbimeve Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	Sipas të gjitha gjasave mungojnë treguesit SMART për monitorim, mungon vlerësimi i jashtëm. Jo të gjithë këshilltarët komunal raportojnë; ka raportim të parregullt dhe të vjetruar
Informimi	Potenciali për të plasuar më shumë informacione tek më shumë fermerë dhe palë të interesit përmes këshilltarëve komunal	.

	Bashkëpunimi dhe komunikim i mirë me prodhuesit bujqësorë	.
	Mundësitë - Faktorët e jashtëm	Kërcënimet - Faktorët e jashtëm
Politika		Politika bujqësore jokonsistente, në mbështetje të sistemit këshillues të Kosovës, sipas standardeve të BE-së
		Vështirësitë në mbështetjen financiare të sistemit këshillues të Kosovës.
Korniza ligjore	Zbatimi i Ligjit për Shërbimet Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural; plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Shërbimet Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe udhëzimeve administrative	.
Buxheti	Buxheti nga Departamenti i Shërbimet Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, MBPZHR dhe mbështetja nga donatorët	Buxheti i pamjaftueshëm dhe mungesa e mbështetjes nga donatorët
Këshilltarët e jashtëm, OJQ-të, shoqatat e fermerëve/prodhuesve dhe të tjerët	Një numër i madh i personelit bujqësor/agronomik të papunë me arsim të lartë mund të nënkontraktohen	Certifikimi është lehtësisht i arritshëm. Ekspertët tjerë mund të jenë të kualifikuar, por jo të certifikuar
	Nëse certifikohen, ata mund të zbatojnë shërbime këshilluese nëse punësohen nga DSHKT (partneritet klasik privato-publik); janë të certifikuar 400 këshilltarë	.
Bashkëpunimi	Bashkëpunimi me vendet fqinje dhe shtetet anëtare të BE-së me marrëveshje	.
	Institucionet arsimore, profesionale dhe kërkimore shkencore në fushën e bujqësisë dhe institucionet tjera profesionale të hapura për bashkëpunim	.
Klientët	Gatishmëria për të mbajtur shënime për fermën	Besueshmëria e kufizuar e fermerëve ndaj këshilltarëve
	Gatishmëria e klientëve për mësim afatgjatë në bujqësi dhe të tjera	.

3.2 Shërbimet këshilluese publike

Struktura dhe organizimi i sistemit këshillues të Kosovës për ZHQBR sipas Ligjit Nr. 04/L-074 duket si në vijim.

Shërbimi Këshillues i Kosovës për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, i cili organizon shërbimin këshillues sipas ligjit, kërkesave të fermerëve dhe komunitetit, është përgjegjës për aktivitetet e shërbimeve këshilluese.

Shërbimet këshilluese publike ofrohen falas.

Shërbimet këshilluese publike organizohen në:

- Nivelin qendror;
- Nivelin komunal.

Në nivelin qendror

Niveli qendror është i organizuar në kuadër të MBPZHR-së nëpërmjet DSHKT-së. Roli i DSHKT-së është që:

- 1) Të menaxhojë dhe koordinojë ofrimin e shërbimeve këshilluese dhe trajnimit bazuar në (të themi) programin trevjeçar të punës për këshilltarët e QIKK-së, për të siguruar realizimin e qëndrueshëm të të gjitha aktiviteteve të transferimit të njohurive (teknike dhe financiare);
- 2) Të propozojë, hartojë dhe sigurojë zbatimin e legjislacionit në fushën e shërbimeve këshilluese për blegtori dhe zhvillim rural.
- 3) Të propozojë, hartojë dhe sigurojë zbatimin e dokumenteve, politikave/strategjive në fushën e shërbimeve këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural.
- 4) Të programojë të gjitha aktivitetet e punës, lidhur me:
 - a) Identifikimin e nevojave;
 - b) Përgatitjen e propozimeve;
 - c) Hartimin e planeve të veprimit; dhe
 - d) Përgatitjen e aktiviteteve sipas kalendarit bujqësor dhe kërkesave nga terreni;
- 5) Të ofrojë mbështetje për këshilltarët publik të QIKK-së (si dhe për këshilltarët privat), për të siguruar që ata të kenë kapacitetin për të informuar, trajnuar dhe motivuar të gjitha kategoritë e fermerëve (udhëheqësi, ndjekësit dhe të tjerët);
- 6) Të monitorojë dhe vlerësojë të gjitha aktivitetet, bazuar në formularin e raportimit mujor (me mbështetjen e TI-së për të bashkuar të gjitha aktivitetet e QIKK-së dhe të gjitha llojet e përfituesve, si FL, FP, nënsektorët, mosha, etj.);
- 7) Të përpilojë, menaxhojë dhe shpërndajë informacione këshilluese, duke përdorur media të ndryshme;
- 8) Të sigurojë kontroll të cilësisë, performancës dhe vlerësimit të ndikimit;
- 9) Të sigurojë informacione në hartimin e politikave të zhvillimit bujqësor dhe rural;
- 10) Të koordinojë të gjitha aktivitetet e akterëve të shërbimeve këshilluese për bujqësi dhe zhvillimi rural;
- 11) Të komunikojë dhe të japë informacion në lidhje me shërbimet këshilluese;
- 12) Të koordinojë aktivitetet e donatorëve ndërkombëtarë; dhe
- 13) Të përpilojë dhe përditësojë regjistrin e të gjithë ofruesve të shërbimeve këshilluese në bujqësi dhe zhvillim rural, përkatësisht të këshilltarëve të certifikuar bujqësor, (publik dhe privat) dhe kompanive të licencuara;

Departamenti është i organizuar në 3 divizione

- 1) Divizioni i Shërbimeve Teknike
- 2) Divizioni i Shërbimeve Fushore të Ektensionit
- 3) Divizioni për Informim, Bashkëpunim, Monitorim dhe Trajnim

Në nivelin komunal

Niveli komunal formohet nga Qendrat Informative Këshilluese Komunale (QIKK). Është planifikuar të fuqizohen të gjitha QIKK-të për përdorim nga fermerët dhe komuniteti rural. QIKK-të janë të pajisura mirë me informacione dhe materiale për ofrimin e këshillave ekstensionale, si dhe janë të pajisura me infrastrukturën bazë mbështetëse (financuar nga MBPZHR dhe donatorët e mundshëm).

Çdo QIKK është e pajisur me të paktën një këshilltar bujqësor për të përmbushur kërkesat e fermerëve.

Përfituesit e synuar të QIKK-ve janë:

- 1) Fermerët komercialë;
- 2) Fermerët e mundshëm komercialë; dhe
- 3) Fermerët që punojnë për jetesë që aktualisht nuk kanë të ardhura të kënaqshme nga bujqësia.

QIKK-të ofrojnë këshilla dhe trajnime për fermerët dhe anëtarët e komunitetit rural. Kjo përfshin ofrimin e njohurive rreth prodhimit të ri bujqësor dhe teknologjive të marketingut në të gjithë sektorët e bujqësisë. Si dhe asistencë në plotësimin e aplikacioneve për pagesa direkte (subvencione) dhe grante të financuara nga buxheti i Kosovës dhe programet zhvillimore të donatorëve/BE-së, si dhe disponueshmëria e materialeve këshilluese me shkrim.

QIKK-të organizohen dhe koordinohen nga DSHKT. Detyrat kryesore të QIKK-së do të jenë në realizimin e këtyre aktiviteteve:

- 1) Vizita e fermerëve për të ofruar këshilla në terren;
- 2) Identifikimi i nevojave për informacion, si dhe hartimi dhe shpërndarja e materialeve informative;
- 3) Organizimi i seminareve, demonstrimeve, ekspozitave bujqësore etj.
- 4) Ofrimi i këshillave të specializuara (në lidhje me blegtorinë, mbrojtjen e bimëve, përpunimin dhe zhvillimin rural);
- 5) Mbështetja për Agjencinë e Pagesave përmes ofrimit të këshillave për MBPZHR-në 2022-2028 dhe granteve dhe pagesave direkte, aktiviteteve informuese, mbështetjes së fermerëve në plotësimin e aplikacioneve, etj.;
- 6) Organizimi i vizitave studimore brenda dhe jashtë Kosovës për shkëmbimin e përvojave dhe vëzhgimin e praktikave më të mira në bujqësi dhe zhvillim rural;
- 7) Ngritja e vetëdijes për shërbimet këshilluese brenda komunës për të siguruar që klientët e shërbimeve këshillues të kenë qasje në këshilla dhe informacione për të përmbushur nevojat e tyre;
- 8) Identifikimi i mësimave të nxjerra dhe burimeve njerëzore të zhvilluara në komunë që mund të jenë të dobishme për të tjerët dhe asistimi në shpërndarjen e informacioneve të tilla brenda komunës;
- 9) Mbështetja në sigurimin e legjislacionit dhe mundësive për fermerët për të marrë kredi për

- biznes;
- 10) Mbështetja e marketingut të prodhimit bujqësor, çmimet, tregjet dhe standardet e prodhimit sipas kërkesave të tregut etj.;
 - 11) Mirëmbajtja e librit të regjistrimit për të gjithë fermerët që kanë përfituar nga mbështetja e shërbimeve këshilluese; dhe
 - 12) Përcjellja e informacionit të fermerët përmes aplikacioneve të TI-së dhe telefonave celularë.

Të dy nivelet rregullohen me ligj dhe udhëzime administrative.

3.3 Ofruesit privatë të shërbimeve këshilluese

Shërbimet këshilluese private për bujqësi dhe zhvillimi rural duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-074, neni 8, ofrohen nga këshilltarët privat, Kompanit keshildhenese, OJQ-të, stacionet veterinare, shoqatat e fermerëve, agro-përpunuesit, perfaqesuesit e imputeve bujqesore, etj.

Ofruesit privat ofrojnë shërbime për fermerët në mënyra direkte dhe indirekte. Ato janë një burim i mirë për transferimin e njohurive dhe informacionit, por ofrimi i një shërbimi të tillë duhet të organizohet mirë dhe të koordinohet me shërbimet këshilluese publike në mënyrë që të mos dyfishohen aktivitetet dhe përpjekjet. Kjo mund të bëhet me një transparencë dhe koordinim më të mirë, si dhe me përcjelljen e raporteve për aktivitetet e zhvilluara në DSHKT, sipas Udhëzimeve Administrative të bazuara në Ligjin për Shërbimet Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.

Shërbimi këshillues privat financohet nga të ardhurat e krijuara nga shërbimet e ofruara (gjithashtu për MBPZHR-në) dhe fondet tjera.

Shërbimet këshilluese private përfshijnë aktivitetet e mëposhtme:

- 1) Shërbimi këshillues për bujqësi dhe zhvillim rural mund të ofrohet edhe nga këshilltarët privatë si persona fizikë dhe juridikë
- 2) Shërbimi këshillues privat financohet nga të ardhurat e krijuara nga shërbimet e ofruara dhe nga donacione të tjera.
- 3) Shërbimet këshilluese private përfshijnë aktivitetet e mëposhtme:

Aktivitetet kryesore të këshilltarëve të sektorit privat për bujqësi janë:

- 1) Të këshillojnë fermerët sipas prioriteteve që i kanë përcaktuar në fermë dhe shoqatë;
- 2) Të prezantojnë praktikën më të mirë të menaxhimit të biznesit të fermave, praktikën e qëndrueshme bujqësore dhe të ndërmarrjeve rurale jobujqësore;
- 3) Të stimulojnë fermerët të përdorin metoda për prodhimin bujqësor që mundësojnë ruajtjen e burimeve natyrore dhe bonitetit të tokës nëpërmjet zbatimit të bujqësisë ekologjike dhe rritjes së nivelit të cilësisë dhe sasisë së kulturave bujqësore dhe produkteve rurale;
- 4) Të inkurajojnë fermerët për të përshtatur prodhimin me kushtet dhe rrethanat natyrore të rajoneve dhe tregjeve;
- 5) Të inkurajojnë dhe mbështesin fermerët në organizimin e tyre në kooperativa dhe shoqata, si dhe të mbështesin ata me shërbime këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural;
- 6) Të mbështesin ministrinë në kuadër të zbatimit të programit për zhvillimin rural dhe masave për pagesat direkte nëpërmjet ofrimit të këshillave përkatëse, aktiviteteve informuese, mbështetjes për fermerët në lidhje me përgatitjen e aplikacioneve;
- 7) Të ofrojnë këshilla për përdorimin e teknologjive të reja;

- 8) Të mbështesin shpërndarjen e informacionit mbi bujqësinë dhe zhvillimin rural për fermerët dhe komunitetin në zonat rurale;
- 9) Të mbështesin procesin e bashkëpunimit ndërmjet fermerëve.

Shërbimet këshilluese private për bujqësi dhe zhvillim rural mund të ofrojnë shërbime këshilluese pa pasur certifikim – përderisa ato do të paguhen nga klientët dhe jo nga MBPZHR-ja.

3.4 Certifikimi i këshilltarëve

Certifikimi

Aktualisht në Kosovë përdoret skema e certifikimit të bazuar në ligj dhe udhëzimi administrativ për shërbimet këshilluese duke ju ofruar mundësi të certifikimit secilit eskepret profesional të kualifikuar bazuar në kritere. Në afat të mesëm mund të jetë e vlefshme të merret në konsideratë miratimi i CECRA-s edhe në Kosovë, për të pasur të njëjtat cilësi këshilluese si konsulentët në vendet e tjera të BE-së.

CECRA (Certifikata e Konsulentëve Evropianë në Zonat Rurale) është një certifikatë që demonstroi kompetencën e duhur për shërbime këshilluese rurale.

Një ndryshim drejt CECRA do të ishte i realizueshëm.

Shërbimet këshilluese dhe mbështetëse nga pikëpamja strategjike

Shërbimet këshilluese dhe mbështetëse adresojnë objektivat e mëposhtme strategjike:

- Rrisin qëndrueshmërisë së përgjithshme të ndërmarrjeve bujqësore/rurale dhe qëndrueshmëria e të gjithë sektorit.
- Ndihmojnë ndërmarrjet individuale rurale të bashkohen në një grup koheziv me vizion të përbashkët në drejtim të përmirësimit të konkurrencës dhe tregjeve të synuara.
- Sigurojnë mbështetje për fermerët në uljen e kostove për njësi të prodhimit, transportit dhe marketingut.
- Inkurajojnë dhe lehtësojnë inovacionin dhe diversifikimin në nivel të ndërmarrjes.
- Mbështesin prodhuesit në rritjen e suficitëve të tregtueshme.
- Lehtësojnë konceptimi dhe krijimin e ndërmarrjeve të reja agro- dhe rurale.
- Ofrojnë mbështetje për pengesat e nivelit të ulët të hyrjes në lidhje me kapitalin, teknologjinë, informacionin dhe qasjen në treg.
- Sigurojnë mbështetje në tërheqjen e kapitalit privat si dhe burimeve të donatorëve ndërkombëtarë;
- Forcojnë lidhjet paraprake me furnitorët si dhe lidhjet e përparme me blerësit.

Megjithatë, efektiviteti i shërbimeve këshilluese varet kryesisht nga arritja paraprake e një numri kushtesh “të nevojshme”, duke përfshirë:

- Sektori publik duhet të krijojë një mjedis politikash dhe rregullator që katalizon iniciativën e sektorit privat.
- Disponueshmëria e burimeve njerëzore të përshtatshme dhe infrastrukturës adekuate për të shpërndarë njohuritë dhe ekspertizën bujqësore.

- Disponueshmëria e të produkteve, duke përfshirë qasjen në kredi aty ku kërkohet, për bizneset e denja për kredi, sistemin adekuat të transportit në mënyrë që të ekzistojë qasja dhe lidhjet ndërmjet prodhuesve dhe konsumatorëve.
- Disponueshmëria e inovacioneve (teknologjisë) të përshtatshme që adresojnë shqetësimet kryesore të bujqësisë dhe komuniteteve rurale (përdoruesit fundorë të shërbimeve këshilluese).
- Funksionimi efektiv i mekanizmave dhe tregjeve të çmimeve.
- Fermerët duhet të kategorizohen sipas nevojave të tyre.
- Nevojat e perceptuara dhe reale të grupeve të ndryshme të fermerëve duhet të identifikohen me saktësi; programet këshilluese duhet të hartohen për të përmbushur kërkesat e secilit grup dhe për të marrë parasysh burimet në dispozicion.
- Lidhjet ndërmjet grupeve të klientëve dhe këshilltarëve duhet të forcohen, për të siguruar që këshilltarët plotësojnë nevojat e fermerëve.
- Lidhjet e dyanshme ndërmjet kërkimit shkencor dhe fermerëve duhet të përforcohen duke përdorur në mënyrë efektive organizatat këshilluese.
- Komuniteti shkencor bujqësor duhet të kuptojë se këshillimi kërkon aftësi që janë të ndryshme, por të barabarta me ato të nevojshme në kërkime.
- Çështjet e zhvillimit rural dhe marrëdhëniet e tij me shërbimet këshilluese bujqësore duhet të adresohen.
- MBPZHR duhet të përcaktojë nëse përdorimi i gjerë i teknologjisë së informacionit është praktik dhe, nëse është, të përgatisë një program që e shfrytëzon plotësisht këtë mjet të fuqishëm.

Sfidat ne Sistemin organizativ

Një nga çështjet kryesore sa i përket strukturës organizative e cila duhet të adresohet ka të bëjë me zgjidhjen e mos funksionimit efikas të sistemit këshillues ndërmjet komunave dhe MBPZHR-së. Prandaj, qëllimi i këtij plani është që këshilltarët komunalë duhet të transferohen në kuadër të DSHKT/MBPZHR-së. Aktualisht këshilltarët komunal kryejnë shërbime për komuna ndërsa sa i përket aktiviteteve që nderlidhen me shërbime këshilluese e realizojnë si aktivitete dytesore, pasi financohen nga buxhetet komunale.

Me zbatimin e këtij plani strategjik MBPZHR është e interesuar që këshilltarët komunalë bujqësor t'i transferoi në kuadër të DSHKT-MBPZHR.

Komunat janë të interesuara t'i transferojnë këshilltarët e tyre për bujqësi në MBPZHR, nëse MBPZHR do t'i punësonte ata nga buxheti i MBPZHR-së. Nëse kjo do të ndodhte, komunat mund të punësojnë menjëherë staf të ri, për të vazhduar punën në agjendat komunale. Duke qenë se kjo punë lidhet shumë me angazhimin e tyre gjatë procesit të aplikimit të subvencioneve për fermerët në krye të skemës kombëtare të mbështetjes, askush nuk mund të ketë interes serioz për ta bërë këtë.

Ky sistem ka nevojë urgjente për një zgjidhje të qëndrueshme të shërbimit këshillues bujqësor ofrohet nga MBPZHR dhe kjo duhet të mundësohet përmes transferimit të këshilltarëve komunal ose rekrutimit të këshilltarëve të rinj në nivel lokal.

Cilado nga zgjidhjet e ofruara për këshilltar komunal, atyre duhet të ju ofrohen kushtet të nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve të shërbimeve këshilluese duhet të kenë zyra nëpër komuna me paisjet e nevojshme,

Pika e fundit që duhet theksuar këtu është partneriteti publiko-privat. Strategjia përmend inkorporimin e më shumë njohurive lokale nga këshilltarët privat, shoqatat, OJQ-të dhe palët e tjera të interesit.

Për të tejkaluar hendekun e njohurive ose eventualisht më mirë problemin e kapaciteteve këshilluese ndërmjet DSHKT-së dhe zgjidhjes së nevojshme nga fermerët dhe ndërmarrjet rurale, detyra specifike duhet t'u jepen shoqatave dhe palëve të tjera të sektorit privat dhe të financohen nga buxheti i MBPZHR-së, shoqatat mund të ofrojnë këshilla për fermerët e sektorit. Prandaj shoqatat e kualifikuara duhet të kenë kapacitetet, njohurive sektoriale dhe besimin e fermerëve apo bizneseve rurale.

Shoqatat e fermereve mund të ofrojnë këshilla për teknologjitë e prodhimit duke përfshirë produktet, mbrojtjen e bimëve dhe trajtimin pas vjeljes; të informojnë për standardet e prodhimit, të organizojnë sesione informuese dhe madje edhe vizita studimore. Qasja do të ishte e ngjashme me DSHKT-në dhe QIKK-në; këshillim përmes trajnimeve teorike në klasa, këshilla praktike në ferma, përgatitje të broshurave (elektronike), organizim i ditëve në terren dhe eventualisht edhe konferenca vjetore.

Ky plan strategjik përmban gjithashtu një shtojcë me praktikatat më të mira nga sistemet këshilluese bujqësore të BE-së, i cili mund të përfshijë tema dhe qasje që mund të zbatohen në këtë plan.

4 Plani Strategjik për Shërbimet Këshillues në Kosovë

4.1 Grupet e synuara

Të gjithë personat fizik dhe juridik të angazhuar dhe të interesuar në aktivitetet e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural në Kosovë.

Fusnotat shpjeguese

- *Fermerët, pronarët e pyjeve, sipërmarrësit e agrobizneseve (përfshirë furnitorët e produkteve, qoftë mikro-ndërmarrjet apo ato të mëdha, qendrat e grumbullimit dhe përpunimit) konsiderohen si klientë të shërbimeve këshilluese; por edhe të rinjtë dhe gratë. Gjithashtu të huajt në rast se janë të interesuar për bujqësinë vendore.*
- *Supozohet se shumica e klientëve janë fermerë të vegjël, por nuk përjashtohen fermerët e mëdhenj apo pronarët e pyjeve.*
- *Për më tepër, aktivitetet bujqësore zakonisht zhvillohen në zonat rurale, por aktivitetet e ardhshme si bujqësia urbane janë gjithashtu pjesë e bujqësisë dhe për këtë arsye zonat urbane do të mbulohen gjithashtu nga shërbimet.*
- *OJQ-të dhe shoqatat e regjistruara janë persona juridik.*

4.2 Vizioni

Zhvillimi dhe avancimi i Sistemit Këshillues të Kosovës për Bujqësi dhe Zhvillim Rural ofron shërbime këshilluese lehtësisht të qasshme, cilësore dhe në kohë. Shërbimet këshilluese do të përputhen me standardet e Sistemit Këshillues të Fermave të BE-së (BE SKF).

Fusnota shpjeguese

- *Meqenëse Kosova po i afrohet BE-së, të gjitha aktivitetet duhet të orientohen drejt kërkesave të BE-së. Është e mundur të fillohet me “versione të lehta”, të cilat mund të përmirësohen me kalimin e kohës; por asnjë aktivitet nuk duhet të shkojë në drejtimin e kundërt siç tregohet nga BE-ja.*

4.3 Misioni

Misioni i SKKBZHR-së është të mbështesë dhe promovojë transferimin e njohurive dhe teknologjive për të rritur produktivitetin, cilësinë, standardet e sigurisë ushqimore, mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin e qëndrueshëm, në përputhje me objektivat e Strategjisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe përafrimin me Politikat Bujqësore të BE-së.

Fusnota shpjeguese

- Konsulenti nuk pajtohet me fjalinë “SKKBZHR-së është në përputhje me objektivat e PBZHR-së dhe Politikave të Përbashkëta Bujqësore të BE-së” pasi është thjesht një deklaratë e paverifikuar dhe paksa e pakuptimtë.

4.4 Objektivat

Plani Strategjik i Sistemit Këshillues të Kosovës për Bujqësi dhe Zhvillim Rural ka këto objektiva strategjike;

- 1) Rritja e numrit të fermerëve dhe akterëve të tjerë që kanë qasje dhe marrin këshilla për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural;
- 2) Përshtatja e shërbimeve këshilluese, sipas nevojave dhe kërkesave të fermerëve, pronarëve të pyjeve dhe palëve të tjera të interesit dhe sipas politikave dhe udhëzimeve të ministrisë;
- 3) Promovimi dhe asistimi në zbatimin e politikave kombëtare të zhvillimit, programeve kombëtare dhe ndërkombëtare në mbështetje të bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural; dhe
- 4) Ngritja e kapaciteteve dhe avancimi i partneritetit publiko-privat në përmirësimin e shërbimeve këshilluese

Fusnotat shpjeguese

- *U diskutua në GP që DSHKT nuk duhet ta shohë veten si njësi zbatuese e projektit; të gjitha departamentet janë të detyruara të ndjekin strategjinë zyrtare dhe të ndihmojnë në zbatimin e saj. - DSHKT ka rol të qartë këshillues, që do të thotë se duhet të informojë fermerët dhe palët e tjera të interesit për programet mbështetëse ekzistuese dhe të ardhshme, por DSHKT nuk është i përfshirë në p.sh. pagesat direkte – përveç si këshilltarë për fermerët. Çdo përfshirje do të ishte një konflikt interesi pasi aktivitetet këshilluese dhe inspektuese nuk mund të jenë në një dorë.*
- *Meqenëse objektivi është rritja e numrit të fermerëve dhe akterëve të tjerë që kanë qasje dhe marrin këshilla për bujqësi dhe zhvillim rural, do të duhej një tregues SMART për të përcjellë nëse do të kishte ndikim.*
- *Nevojat dhe kërkesat e fermerëve, pronarëve të pyjeve dhe palëve të tjera të interesit përfshijnë informacionet rreth skemave mbështetëse.*

Plani i veprimit strategjik

Strategjia ka të bëjë me personelin dhe kapacitetet e duhura materiale të Shërbimit Këshillues Bujqësor.

Hapi i parë në vendosjen e tij në përputhje me ligjin është zbatimi i një programi trajnimi për certifikimin e këshilltarëve bujqësor, i pasuar nga trajnimi i vazhdueshëm vjetor i këshilltarëve bujqësor për të përmirësuar njohuritë dhe aftësitë e tyre.

Hapi tjetër është forcimi i sistemit të Shërbimit këshillues Bujqësor në Kosovë në të gjitha nivelet e veprimit, në përputhje me ligjin, duke marrë parasysh gjendjen e prodhimit bujqësor dhe nevojat e fushës. Në bazë të kësaj që u cek më sipër, është përcaktuar përshkrimi i punës së këshilltarëve për bujqësi sipas fushave të specializuara dhe është përcaktuar numri i këshilltarëve bujqësor në Kosovë, të cilët kanë qenë të nevojshëm për zbatimin e Strategjisë.

E rëndësishme për punën e Shërbimit Këshillues Bujqësor është lidhja me institucionet kërkimore-arsimore dhe profesionale për transferimin e arritjeve kërkimore dhe teknologjive të reja në prodhimin bujqësor, nga njëra anë, dhe nga ana tjetër, drejtimin e zhvillimit të kërkimit parësor në bujqësi në drejtim të plotësimit të nevojave të ekonomisë bujqësore dhe prodhuesve.

Promovimi i shërbimeve këshilluese nëpërmjet krijimit dhe zhvillimit të faqes së internetit të Shërbimit Këshillues dhe krijimit të buletinit të Shërbimit Këshillues Bujqësor është shumë i rëndësishëm për ngritjen e kapaciteteve të Shërbimit Këshillues Publik Bujqësor.

Masat që duhen marrë

Mekanizmi bazë për zhvillimin e sistemit funksional të Sistemit të Shërbimit Këshillues Bujqësor në Republikën e Kosovës është zbatimi i ligjit:

- Ngritja dhe forcimi i kapaciteteve të këshilltarëve bujqësor,
- Krijimi i një shërbimi këshillues bujqësor me kapacitet dhe personel që korrespondon me nevojat e fushës.
- Krijimi i financimit të qëndrueshëm të shërbimit nga të gjitha nivelet e organizatës.

Një mekanizëm i rëndësishëm në ngritjen e kapaciteteve të Shërbimit Këshillues Bujqësor është lidhja me institucionet shkencore - kërkimore dhe profesionale për transferimin e arritjeve kërkimore dhe teknologjive të reja në prodhimin bujqësor përmes fermave demonstruese, ditëve në terren etj.

4.5 Riorganizimi

Plani për riorganizimin dhe fuqizimin e Departamentit të Shërbimeve Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2023-27

Plani i riorganizimit parasheh ndryshimin e emrit të departamentit dhe përshtatjen e tij me dokumentet bazë si ligji dhe strategjia, dhe tani e tutje DSHKT do të quhet Departamenti i Shërbimeve Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (DSHKBZHR). Është ndryshuar edhe në ligjin për shërbime këshillues, i cili është në Kuvend, ku përmes këtij amendamenti parashikohet mundësia e transferimit të këshilltarëve publik komunal në kuadër të buxhetit të Ministrisë së Bujqesise, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ose përmes procedurave të behet rekrutimi i këshilltarëve të rinj në komuna si staf i Ministrisë së Bujqesise.

Në këtë plan të riorganizimit, paraqiten vetëm ndryshimet që do të ndodhin;

Shërbimet këshilluese publike organizohen dhe shtrihen në:

- Nivelin qendror
- Nivelin komunal

Niveli qendror është i organizuar në MBPZHR përmes Departamentit të Shërbimeve Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural. Ndryshim tjetër është planifikimi i hapjes së zyrave rajonale në nivel qendror, ku në 7 zyrat rajonale pritet të vendosen 7 koordinatorë të cilët do të organizojnë dhe bashkërendojnë punën në terren me BKP-b-të nëpër komuna.

Përshkrimi i detyrave mbetet i njëjtë si më lart për nivelin qendror, nivelin komunal si dhe sektorin privat për këshillim.

Sistematizimi i vendeve të punës për Departamentin e Shërbimeve Këshillues për Bujqësi dhe Zhvillim Rural do të bëhet me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në MBPZHR, e cila është në proces.

Koordinatorët rajonalë (7) do të kenë këto detyra kryesore:


- Koordinimi i aktiviteteve me këshilltarët komunal.
- Sigurimi i informacionit për këshilltarët komunal.
- Menaxhimi i trajnimeve të nevojshme në nivel rajonal.
- Monitorimi i kontrollit të cilësisë për konsulentët publik dhe privat që operojnë në komunat që mbulojnë.
- Marrin pjesë në hartimin e planeve vjetore të punës për komunat që koordinon dhe planin për ngritjen e kapaciteteve të këshilltarëve në terren sipas kërkesave të tregut.
- Raportimi në Departamentin e Shërbimeve Këshillues për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, veçanërisht Divizioni i Shërbimeve Fushore të Ekstensionit

Departamenti i Shërbimeve Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural ka identifikuar për përdorim tri qendra trajnimi për fermerët dhe këshillat në kuadër të bashkëpunimit:

- Qendra e trajnimit në Lipjan
- Qendra e trajnimit në Pejë
- Qendra e trajnimit në Rahovec

Organogrami

1. Niveli qendror



2. Niveli komunal

QIKK-të						
Prishtinë	Mitrovicë	Pejë	Gjakovë	Prizren	Ferizaj	Gjilan
Podujevë	Skenderaj	Istog	Junik	Dragash	Shtime	Novobërdë
Drenas	Vushtrri	Klinë	Rahovec	Suharekë	Hani i Elezit	Kamenicë
Obiliq	M. e Veriut	Deçan	Malishevë	Mamushë	Kaçanik	Ranilluk
Fushë Kosovë	Zubin Potok	Junik			Shtërpçë	Patesh
Lipjani	Leposaviq					Klllokot
	Zveçan					Viti

Departamenti i Shërbimeve Këshilluese në kuadër të MBPZHR-së duhet të lehtësojë të gjitha shërbimet e përshkruara sipas objektivave. Lehtësimi nuk do të thotë zbatim, por të sigurohet që dikush po zbaton shërbimet e kërkuara. Shumica e shërbimeve do të ofrohen nga stafi i ministrisë dhe komunës, megjithatë shërbimet mund të nënkontraktohen nga personat tjerë të certifikuar, kompanitë, shoqatat dhe institucionet. Në atë rast, kur të tjerët ofrojnë shërbime për MBPZHR-në, ata duhet të kompensohen financiarisht për punën e tyre përmes buxhetit të Departamentit të Shërbimeve Këshilluese(DSHKBZHR).

Këshilltarët e vendosur në zonat rurale, aktualisht në QIKK, mund të kërkojnë gjithmonë mbështetje nga një institucion më i specializuar; p.sh., universitetet, stacionet kërkimore, por edhe sektori privat

Struktura dhe organizimi i Strategjia Kombëtare për Bujqësi dhe Zhvillim Rural

Zhvillimi i Strategjisë Kombëtare për Bujqësi dhe Zhvillim Rural përfshin bashkëpunimin ndërmjet akterëve të ndryshëm që janë të përfshirë drejtpërdrejt dhe tërthorazi në bujqësi (shih grafikun më poshtë), dhe ata janë:

- 1) DSHKT/MBPZHR;
- 2) Qendra Informative Këshilluese Komunale (QIKK) për bujqësi dhe zhvillim rural;
- 3) Ofruesit privatë të shërbimeve këshilluese;
- 4) Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (Agjencia e Pagesave);
- 5) Fakulteti i Bujqësisë, Universiteti i Prishtinës;
- 6) Instituti Bujqësor i Kosovës, Pejë;
- 7) Agjencia e Pyjeve(APK)
- 8) Departamenti për Vreshtari dhe Verëtari;
- 9) Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë e Kosovës;
- 10) Shkollat Profesionale Bujqësore;
- 11) Bizneset agro-ushqimore;
- 12) Bizneset rurale, p.sh. furnitorët e produkteve, qendrat e grumbullimit të mallrave, etj.; dhe
- 13) Fermerët dhe komuniteti rural, duke përfshirë Grupet Lokale të Veprimit.

Për më tepër, këshilltarët komunalë për bujqësi dhe zhvillim rural janë pjesë e shërbimeve këshilluese të vendosura në kuadër të Qendrave Informuese Këshilluese Komunale (QIKK) (dhe financohen nga komunat). Pavarësisht se janë në çështje administrative nën komunat, ato ofrojnë shërbime këshilluese bazuar në Ligjin ne fuqi dhe aktet nenligjore dhe udhëzueseve ptofrsional.

Për një bashkëpunim më të mirë ndërmjet nivelit qendror dhe atij komunal, në QIKK do të vendosen 7 koordinatorë rajonalë të rinj të punësuar; këta koordinatorë rajonalë do të financohen nga MBPZHR dhe ky staf do të koordinojë dhe këshillojnë në nivel komunal. Si qëllim afatmesëm, është paraparë transferimi i këshilltarëve komunalë në stafin e MBPZHR-së siq eshte parapar ne Strategjine Strategjina për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.

Krahas personelit të përhershëm në Departamentin e Shërbimeve Këshilluese në kuadër të MBPZHR-së dhe në Qendrat Informuese Këshilluese Komunale, MBPZHR mund të punësojë ekspertë të kualifikuar përkohësisht nga jashtë, nëse mungojne kapacitet e mjaftueshme.

Metodat e këshillimit

- Duke iu qasur individëve
- Duke iu iu qasur grupeve
- Metodat masive

Qasjet këshilluese

- a) Këshilla direkte, ballë për ballë në fermë ose në zyrë dhe me telefon/takim virtual
- b) Këshillim në grup – kryesisht në terren
- c) Demonstrime praktike dhe ditë fushore të organizuara në terren me fermerët
- d) Ligjërata dhe punëtori profesionale për tema të veçanta
- e) Demonstrime që synojnë të prezantojnë GAP-in si dhe arritjet e teknologjisë
- f) Parcela demonstruese dhe eksperimentale, në institutet shtetërore ose tek fermerët model (pra pa pagesa shtesë)
- g) Rrethet bujqësore
- h) Seminare trajnimi dhe takime informuese me prezencë ose nëpërmjet webinarëve
- i) Faqja e internetit e MBPZHR/DSHKT-së
- j) Platformat bujqësore dhe mediat e reja
- k) Këshilla konsultativ jozyrtar për çdo zyre komunale
- l) Broshura, libër udhëzues, manual, fletëpalosje dhe botime të tjera, të cilat përmbajnë këshilla dhe informacione për tema të ndryshme.

Të gjithë ofruesit e shërbimeve këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural në punën e tyre janë të obliguar t'u përmbahen metodave të punës këshilluese të përcaktuara në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-074 dhe aktete nenligjore të nxejura prej tij.

Temat/çështjet që mbulohen nga shërbimet këshilluese bujqësore

- Prodhimtaria bimore dhe hortikultura
- Blegtoria
- Peshkataria
- Bletaria
- Agro-përpunimi
- Bujqësia organike – bujqësia e qëndrueshme – bujqësia rigjeneruese – çështjet mjedisore
- Pylltaria dhe agro-pylltaria (duke përfshirë PPJD, BMA, etj.)
- Agro-turizmi
- Ekonomia dhe financat (menaxhimi i fermave, agro-financat, sigurimet, mbajtja e llogarive dhe kontabiliteti, etj.)
- Diversifikimi i aktiviteteve rurale
- Energjia e ripërtëritshme (biomasë, biogaz, diellorë/fotovoltaikë)
- Siguria e ushqimit
- Shërbime ligjore
- Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK)
- Bujqësia digjitale
- Inovacionet bujqësore
- Bujqësia/bujqësia urbane
- Sigurimet bujqësore

- Njohja me kriteret, procedurat e aplikimit dhe zbatimin e granteve dhe subvencioneve
- Çështjet/temat tjera sipas kërkesave.

Financimi

Financimi i Shërbimeve Këshilluese bëhet nga buxheti i MBPZHR-së dhe donatorëve. Në kapitullin vijues, në Planit e Veprimit shtjellohet një matricë që tregon jo vetëm aktivitetet/projektet, treguesit dhe afatet kohore por edhe buxhetin e vlerësuar sipas aktivitetit/projektit. Për më tepër, ekziston një buxhet i përgjithshëm indikativ për vitet e ardhshme deri në vitin 2027.

Fusnotat shpjeguese

- Aktualisht janë 13 anëtarë të stafit në kuadër të departamentit dhe 38 në kuadër të komunave. 7 koordinatorë do të angazhohen deri në fillim të vitit 2023.
- Grupi Punues dëshiron t'i përmbahet certifikimit në parim; kjo ka kuptim nëse të gjitha aktivitetet e financuara në kuadër të shërbimeve këshilluese bujqësore do të duhet të kryhen vetëm nga këshilltarë të certifikuar; kjo do të vlente edhe për p.sh. profesorët e universitetit.
- Ky dokument strategjik ka të bëjë me strategjinë e Departamentit të Shërbimeve Këshilluese dhe Teknike në MBPZHR. Prandaj, duhet të shpjegojë organizimin ndërmjet departamentit dhe njërive/institucioneve vartëse si Qendrat Komunale Informative, ku këshilltarët komunalë për bujqësi janë duke punuar në kuadër të MBPZHR-së. Të gjitha marrëveshjet e tjera të bashkëpunimit si me Institutin Bujqësor të Kosovës në Pejë duhet të përmbledhen në SNJIB. Të Departamenti i Shërbimeve Këshilluese dhe Teknike është pjesë e SNJIB-së.
- Ofrimi i shërbimeve këshilluese për një grup fermerësh do të jetë më efikas.
- Shërbimet do të përdorin mjete digjitale, pasi ato janë më të lira për t'u prodhuar dhe mund të adoptohen më shpejt në rrethana të reja.
- Faqet e internetit duhet të ndërtohen lehtësisht në mënyrë që shumica e anëtarëve të DSHKT-së të mund të përvetësojnë përmbajtjen.
- Shërbimet veterinarë - nëse kanë kontekst mjekësor - nuk zbatohen nga Departamenti i Shërbimeve Këshilluese dhe Teknike. Megjithatë, do të jepen këshilla të përgjithshme për bagëtinë në lidhje me përbërjen e ushqimit dhe kërkesat për foragjere.
- Këshilltarët që janë të vendosur në zonat rurale, aktualisht në Qendrat Komunale Informative, mund të kërkojnë gjithmonë mbështetje nga një institucion më i specializuar; p.sh., universitetet, stacionet kërkimore, por edhe sektori privat – për sa kohë që janë pjesë e SNJIB-së së ardhshme.

4.5.1 Monitorimi & Vlerësimi

Monitorimi dhe vlerësimi i SKKBZHR-së

Monitorimi (dhe vlerësimi) është një pjesë thelbësore e procesit të menaxhimit. Monitorimi sistematik i aktiviteteve nga SKKBZHR-së:

- 1) Rishikon performancën e SKKBZHR-së në arritjen e objektivave të përgjithshme strategjike dhe planit operacional;
- 2) Identifikon ndryshimet e nevojshme në planin operativ në nivel komunal;

- 3) Mbështet procesin e planifikimit dhe përditësimit të shërbimeve të SKKBZHR-së dhe aktiviteteve të zyrtarëve dhe ekspertëve;
- 4) Mbështet vendimet e menaxhmentit;
- 5) Kontrollon përdorimin e burimeve në lidhje me ofrimin e shërbimeve këshilluese;
- 6) Siguron transparencë dhe përgjegjësi për zbatimin e aktiviteteve të KASARD; dhe
- 7) Mundëson identifikimin e problemeve/gabimeve më herët, në mënyrë që zgjidhja (tejkalimi) i tyre të menaxhohet në mënyrë efikase dhe me kohë.

Përgjegjësia për monitorimin

Divizioni për Informim, Bashkëpunim, Monitorim dhe Vlerësim përmes zyrtarit të monitorimit dhe vlerësimit është përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin e Departamentit të Shërbimit Këshillues për Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe planit strategjik të SKKBZHR-së. Divizioni në fjalë është përgjegjës për mbikëqyrjen e monitorimit sistematik të të gjitha aktiviteteve të DSHKT-së në emër të Drejtorit të Departamentit të Shërbimeve Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural. Përveç kësaj, MBPZHR përmes Departamentit të Shërbimeve Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural mund të kontraktojë monitorues të pavarur, profesionistë të palëve të treta për të kryer aktivitetet e monitorimit dhe vlerësimit.

Detyrat e Divizioni për Informim, Bashkëpunim, Monitorim dhe Vlerësim:

- 1) Të krijojë një mekanizëm efektiv monitorimi dhe raportimi në përputhje me kërkesat e monitorimit dhe raportimit dhe të sigurojë zbatimin e Planit Strategjik të sistemit këshillues për bujqësi dhe zhvillim rural.
- 2) Të përgatisë raporte të rregullta vjetore për zbatimin e dokumentit strategjik
- 3) Të rishikojë performancën e Departamentit të Shërbimeve Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në arritjen e objektivave të përgjithshme strategjike dhe planit operativ;
- 4) Të identifikojë ndryshimet e nevojshme në planin operativ në nivel komunal;
- 5) Të mbështesë procesin e planifikimit dhe përditësimit të shërbimeve të Departamentit të Shërbimeve Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe aktivitetet e zyrtarëve dhe ekspertëve;
- 6) Të mbështesë vendimet e menaxhmentit;
- 7) Të kontrollojë përdorimin e burimeve në lidhje me ofrimin e shërbimeve këshilluese;
- 8) Të sigurojë transparencë dhe përgjegjësi për zbatimin e aktiviteteve të Departamentit të Shërbimeve Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural; dhe
- 9) Të mundësojë identifikimin e problemeve/gabimeve më herët, në mënyrë që zgjidhja (tejkalimi) i tyre të menaxhohet në mënyrë efikase dhe me kohë.

Monitorimi i ndikimit

Monitorimi i ndikimit kryhet në dy nivele:

- 1) Progresi drejt arritjes së objektivave strategjike të Departamentit të Shërbimeve Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural; dhe
- 2) Progresi drejt arritjes së objektivave në planin operativ të Departamentit të Shërbimeve Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural për zhvillimin e aktiviteteve trajnimeve dhe trajnimeve nëpërmjet QIKK-ve.

Mjetet e monitorimit

Këto mjete të monitorimit përdoren:

- 1) Korrespondenca administrative hyrëse dhe dalëse e regjistruar nga Departamenti i Shërbimeve Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, MBPZHR;
- 2) Raportet e vizitave në terren në vendin e ngjarjes;
- 3) Studimet;
- 4) Pyetësorët e ndryshëm;
- 5) Analiza/informacioni bazë;
- 6) Anketat;
- 7) Raportet mbi vizitat/studimet ndërkombëtare;
- 8) Raportet për buxhetin dhe financat;
- 9) Raportet ad hoc;
- 10) Raportet mujore, tremujore dhe vjetore (të stafit); dhe
- 11) Treguesit e monitorimit, duke përfshirë vlerësimin e ndikimit tek përfituesi.

Komisioni për mbikëqyrjen e shërbimeve këshilluese për bujqësi dhe zhvillimin rural.

MBPZHR është përgjegjëse për mbikëqyrjen e shërbimit këshillues për bujqësi dhe zhvillim rural; baza ligjore përkatëse është Ligji për Shërbimet Këshilluese dhe Udhëzimi Administrativ e 11/2015 për përbërjen, punën dhe autorizimet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Shërbimeve Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.

Komisioni përbëhet nga të gjithë partnerët publiko-privat të SKKBZHR-së dhe është kompetent për të siguruar mbikëqyrjen e tërë SKKBZHR-së përfshirë edhe planin strategjik, përmes vlerësimit të planeve dhe raporteve të monitorimit si dhe miratimin e tyre.

5 Plani i Veprimit 2023 – 2027

Ky plan i veprimit propozon aktivitetet dhe projektet e mëposhtme gjatë viteve të ardhshme. Veprimet e propozuara janë diskutuar në Grupin Punues duke u bazuar në nevojat e përgjithshme, si dhe duke marrë parasysh vërejtjet e miratuara nga MBPZHR në “Strategjinë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022 – 2028”. Zbatimi i këtij plani të veprimit është përgjegjësi e DSHKBZHR-së në bashkëpunim me palet e interesit.

5.1 Plani i veprimit në formë të matricës SMART dhe buxheti paraprak

Plan veprimi me tregues dhe buxhet indikativ

Objektivat	Projektet	Aktivitetet	Burimet e financimit	Buxheti 2023	Buxheti 2024	Buxheti 2025	Buxheti 2026	Buxheti 2027	Institucione t përgjegjëse dhe mbështetëse	Produkti / rezultati
1 Objektivi - Rritja e numrit të fermerëve dhe aktorëve të tjerë që kanë akses dhe marrin këshilla për bujqësinë, pylltarinë dhe zhvillimin rural										
1.1 Objektivat specifike - Zhvillimi i zonave rurale nëpërmjet avancimit të shërbimeve këshilluese	1) Trajnimi i këshilltarëve publiko-privat 2) Trajnimi dhe këshillimi i fermerëve 3) Publikimi i broshurave 4) Vizitat fermer-fermer 5) Organizimi i trajnimeve / konsultimeve speciale për gratë fermere dhe të rinj	75 këshilltarë publikë dhe privatë; 350 grupe fermer të trajnuara; 8 tituj broshurash, 24000 kopje; 18 vizita; 450 fermerë të këshilluar; organizimi i trajnimeve për gjithsej 50 fermere gra dhe fermerë të rinj	Nga buxheti i Departamentit të Shërbimit Këshillimor për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në kuadër të MBPZHR-së dhe nga donatorët	105,000	105,000	200,000	200,000	200,000	MBPZHR-ja dhe donatorët	Mbyllja e hendeqeve të njohurive në DSHKBZHR-së duke bartur disa punë trajnuese dhe këshilluese tek sektori privat (këshilltarët privatë, shoqatat, OJQ-të si IADK - Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës, dhe palët e tjera të interesit). Duhet të përcaktohet puna që do të jepet për palët e jashtme, të përcaktohet numri i ditëve të punës dhe të përcaktohet një tarifë gjithëpërfshirëse për konsulentin e sektorit privat.
1.2 Objektivat specifike - Organizimi i parcelave demonstruese	1) Identifikimi i fermerëve dhe arave demonstruese në kuadrin e komunave 2) Përcaktimi i kulturave për fushat demonstruese 3) Institucionet përgjegjëse për përzgjedhjen dhe transferimin e arave	21 zona demonstruese në kuadër të 7 rajoneve, përzgjedhja e kulturave për demonstrim sipas Departamentit të Shërbimit Këshillimor për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, MIAC, Fakultetit të Bujqësisë, AUV, KFA, Departamentit për Vreshtari dhe Verëtarë, etj.	Nga buxheti i Departamentit të Shërbimit Këshillimor për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në kuadër të MBPZHR-së dhe nga donatorët	60,000	60,000	50,000	50,000	50,000	MBPZHR-ja dhe donatorët	
1.3 Objektivat specifike - Fuqizimi i grave fermere dhe fermerëve të rinj	1) Identifikimi i grave 2) Organizimi i trajnimeve për gratë 3) Mbështetja përmes këshillave bujqësore 4) Stimulimi i të rinjve për t'u angazhuar në bujqësi	50 gra fermere marrin të paktën dy herë në vit trajnime në grup dhe mbështetje individuale në fermë sipas nevojës; 30 trajnime përmes trajnimit dhe edukimit të fermerëve të rinj	Nga buxheti i Departamentit të Shërbimit Këshillimor për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në kuadër të MBPZHR-së dhe nga donatorët	20,000	20,000	20,000	25,000	25,000	MBPZHR-ja dhe donatorët	

2 Objektivi - Promovimi dhe ndihma në zbatimin e politikave kombëtare zhvillimore, programeve kombëtare dhe ndërkombëtare në mbështetje të bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural.	1									
2.1 Objektivat Specifike - Avancimi I - Sistemi i Informacionit dhe Komunikimit për Shërbimet Këshillimore	1) Krijimi i sistemit dixhital të formularëve të raportimit 2) Krijimi i bazës së të dhënave të sistemit këshillimor të formularëve të raportimit 3) Krijimi i faqes së internetit të Departamentit 4) Regjistrat dixhitalë të këshilltarëve publikë dhe privatë 5) Krijimi i një biblioteke elektronike dhe tradicionale me titujt përkatës 6) Sigurimi i lehtësirave të nevojshme për dixhitalizim 7) Krijimi i një platforme këshilluese të aksesueshme nga telefonat inteligjentë	1) Vendosja e sistemit funksional 2) Vendorsja e bazës së të dhënave dhe përditësimi i saj i vazhdueshëm; raporte të standardizuara 3) Funksionalizimi i faqes se internetit 4) Numri i librave dhe artikujve elektronikë të gatshëm për shkarkim në faqen e internetit të Departamentit	Nga buxheti i Departamentit të Shërbimit Këshillimor për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në kuadër të MBPZHR-së dhe nga donatorët	100,000	30,000	30,000	30,000	30,000	MBPZHR-ja dhe donatorët	Një zgjidhje që mund të zbatohet dhe nuk ekziston vetëm në letër si kjo aktualja. Synimi është që Departamenti të ketë këshilltarë në terren, të stacionuar në zyrat komunale, të cilët koordinohen dhe menaxhohen drejtpërdrejt nga Departamenti.
2.2 Objektivat specifike - Forcimi i sistemit të monitorimit dhe vlerësimit në kuadër të Departamentit të Shërbimit Këshillimor për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	1) Përgatitja e planit të monitorimit dhe vlerësimit 2) Matja e performancës përmes treguesve 3) Krijimi i një kornize monitorimi 4) Përgatitja e udhëzimeve për procedurat e monitorimit dhe vlerësimit	1 planiti monitorimit dhe vlersimit i pergaditur 2 Matja e performances permes indikatorëve e realizuar 3 korniza monitoruese e krijuar 4 udhezuesi per procedruat e monitorimit dhe vlersimit i pergaditur	Nga buxheti i Departamentit të Shërbimit Këshillimor për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në kuadër të MBPZHR-së dhe nga donatorët	15,000	15,000	5,000	5,000	5,000	MBPZHR-ja dhe donatorët	Përshkrime të qarta të punës me detyra javore dhe SMART indikatorë për të matur ndikimin e punës së tyre

3 Objektivi - Riorganizimi dhe fuqizimi i Shërbimeve Këshillimore										
3.1 Objektivat specifike - Ngritja e kapaciteteve dhe avancimi i partneritetit publik-privat në përmirësimin e shërbimeve këshillimore	1) Krijimi i Zyrës Këshilluese Rajonale 2) Transferimi i këshilltarëve komunal në kuadër të Departamentit dhe MBPZHR-së 3) Avancimi i procesit dhe certifikimi i këshilltarëve bujqësorë në përputhje me rregullat e BE-së (CECRA) 4) Avancimi i procesit të licencimit të subjekteve juridike të cilat ofrojnë shërbime Këshilluese 5) Plotësim në ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-074 për Shërbimet Këshilluese dhe akteve nënligjore	Krijimi dhe funksionimi i 7 Zyrave Rajonale Këshilluese; transferimi i 38 këshilltarë komunalë në Departament dhe MBPZHR; plani i trajnimit për certifikim të harmonizuar; certifikimi i këshilltarëve në përputhje me rregullat e BE-së (CECRA); avancimi i procesit të licencimit të personave juridikë të cilët ofrojnë shërbime këshilluese në përputhje me udhëzimet administrative; Hartimi dhe miratimi i Ligjit Nr. 04/L-074 për Shërbimet Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe akteve nënligjore,	Nga buxheti i Departamentit të Shërbimit Këshillimor për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në kuadër të MBPZHR-së dhe nga donatorët	60,000	90,000	120,000	150,000	160,000	Departamenti i Shërbimeve Këshillimore për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	
3.2 Objektivat specifike - Koordinim më i mirë i sistemit këshillimor publiko-privat	1) Fuqizimi i Komisionit Mbikëqyrës të Strategjisë Kombëtare për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural 2) Organizimi i takimeve të rregullta me OJQ-të dhe kompanitë e licencuara 3) Bashkëpunimi me institucionet arsimore dhe kërkimore-shkencore.	1) Komisioni Mbikëqyrës i Strategjisë Kombëtare funksionon sipas Ligjit të Organizatës 2) Takime të rregullta me OJQ-të dhe kompanitë e licencuara 3) Nënshkrimi i memorandumeve të bashkëpunimit me institucionet arsimore dhe kërkimore-shkencore.	Buxheti i DSHKBZHR-së brenda buxhetit të MBPZHR-së dhe donatorët	20,000	0	0	0	0	Departamenti i Shërbimeve Këshillimore për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	
3.3 Objektivat specifike - Bashkëpunimi i Departamentit të Shërbimit Këshillimor për Bujqësi dhe Zhvillim Rural me sisteme të ngjashme në rajon dhe në BE	1) Pjesëmarrja në takimet e rregullta të Sistemit Këshillimor të Rajonit 2) Aplikimi për anëtarësim në Organizatat e BE-së për shërbime këshillimore 3) Shkëmbimi i provave dhe praktikave të mira në lidhje me shërbimet e këshillimit të vendeve të ndryshme të BE-së	Pjesëmarrja në 2 takime të rregullta të Sistemit Këshillimor të Rajonit; aplikimi i dërguar për anëtarësim në organizatat e BE-së për këshillim; kryerja e gjithsej 2 vizitave në vende të ndryshme të rajonit dhe të BE-së	Nga buxheti i Departamentit të Shërbimit Këshillimor për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në kuadër të MBPZHR-së dhe nga donatorët	50,000	50,000	70,000	70,000	80,000	Departamenti i Shërbimeve Këshillimore për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	Procesi i certifikimit është transparent. Një numër këshilltarësh të mirë kualifikuar janë punësuar dhe nënkontraktuar për të siguruar ofrimin e shërbimeve cilësore për fermerët, sipërmarrësit ruralë dhe palët e tjera të interesit.
3.4 Objektivi specifik - Logjistikë më e mirë për shërbime këshilluese më efikase	1) Furnizimi i 7 zyrave rajonale me inventar dhe pajisje pune 2) Furnizimi me material shpenzues për 38 këshilltarët komunal	7 zyrat rajonale të pajisura me inventar dhe pajisje pune; furnizimi me material shpenzues për 38 këshilltarët komunalë	Nga buxheti i Departamentit të Shërbimit Këshillimor për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në kuadër të MBPZHR-së dhe nga donatorët	130,000	70,000	10,000	10,000	10,000	Departamenti i Shërbimeve Këshillimore për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	Këshilltarët mund të përgjigjen menjëherë dhe të dalin në terren për të zgjidhur problemet atje
TOTALI në EUR				560,000	440,000	505,000	540,000	560,000		
Viti				2023	2024	2025	2025	2025		

5.2 Buxheti i përgjithshëm indikativ për DSHKT-në

Departamenti për shebrime këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural

Tabela - Parashikimi i buxhetit 2023 – 2027 në EUR

Zërat	2023	2024	2025	2026	2027
Pagat dhe pagesat ditore	107 253	107 253	107 253	107 253	107 253
Mallrat dhe shërbimet	502 380	600 000	650 000	700 000	750 000
Kontributi i donatorëve	50 000	200 000	200 000	200 000	200 000
Gjithsej në EUR	659 633	907 253	957 253	1 007 253	1 057 253

5.3 Hapat e zbatimit dhe rreziqet e përfshira

Veprimtaria këshilluese në Republikën e Kosovës rregullohet me Ligjin për Shërbimet Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural. Strategjia afatmesme për ofrimin e shërbimeve këshilluese (2023 – 2027) gjurmon rrugën drejt arritjes së objektivave të përcaktuara. Ajo do të zbatohet gradualisht në vitet në vijim, deri në vitin 2027. Në fund të periudhës do të vlerësohet suksesi i zbatimit të sa dhe arritja e objektivave. Vlerësimi i suksesit të zbatimit të strategjisë do të bëhet publik.

- Ngritja e strukturave të Shërbimeve Këshilluese Publike për Bujqësi siguron interesin publik dhe mundësinë për qasje në ofrimin e Shërbimeve Publike për të gjithë fermerët. Financimi i saj sigurohet nga buxheti dhe nga burime të tjera.
- Shërbimi privat këshillues për bujqësi me aktivitetet e tij specifike siguron konkurrencën e ofertës së shërbimeve këshilluese. Shërbimet private këshilluese bujqësore krijohen dhe financohen në përputhje me ligjin. Partneritetet mund të lidhen me Shërbimet Këshilluese Publike për Bujqësi, komunitetet lokale, subjektet e biznesit dhe institucionet profesionale, duke ofruar kështu një partneritet publiko-privat.
- Shërbimet këshilluese në punën e tyre duhet t'u përmbahen metodave të punës këshilluese. Puna e këshilltarëve bujqësor me grupet e prodhuesve bujqësorë siguron efikasitet dhe punë me të gjitha kategoritë e popullsisë nga zonat rurale.
- Për zbatimin sa më efektiv të Strategjisë, është i nevojshëm drejtimi i punës së Shërbimeve Këshilluese Publike për Bujqësi, propozimi i masave dhe zgjidhjeve korrigjuese për eliminimin e vështirësive të mundshme në punën e tij, si dhe bashkëpunimi ndërmjet Shërbimeve Këshilluese Publike për Bujqësi dhe shërbimeve private këshilluese për bujqësi, si dhe formimi i një trupi të përhershëm punues për të koordinuar punën e shërbimeve këshilluese bujqësore në Republikën e Kosovës në kuadër të MBPZHR-së.

Rreziqet e mëposhtme që mund të priten në zbatimin e strategjisë afatmesme për ofrimin e shërbimeve këshilluese në Republikën e Kosovës 2023-2027:

- 1) Organizmi dhe fuqizimi jo i plot i sistemit këshillues të DSHKBZHR;
- 2) Korniza ligjore, mosaprovimi i Ligjit të ri;
- 3) Koordinim i pamjaftueshëm i paleve të interesit në sistemin këshillues
- 4) Burimet financiare të kufizuara;
- 5) Pengesat në procedurat administrative.

6 SNJIB - një këndvështrim


Termi Sisteme të Njohurive dhe Inovacionit në Bujqësi (SNJIB) përshkruan të gjithë sistemin e shkëmbimit të njohurive: mënyrat se si njerëzit dhe organizatat ndërveprojnë brenda një vendi, ose një rajoni. SNJIB mund të përfshijë praktikën bujqësore, bizneset, autoritetet, kërkimin shkencor, etj. dhe mund të ndryshojë shumë, varësisht nga vendi ose sektori. Një SNJIB i mirë merr parasysh dimensionet teknike, organizative dhe sociale (“qasja sistematike”), dhe kjo ndihmon për të kapërcyer hendekun mes shkencës dhe praktikës. Për më tepër, SNJIB ndihmon për të lidhur njerëzit dhe për t’u siguruar që njohuritë të ndahen mes të gjithë atyre që e përdorin dhe e prodhojnë atë. Aktualisht, shumë vende, përfshirë Kosovën, përballen me problemin që kërkimet bujqësore bëhen nga organizatat qeveritare, por gjetjet nuk i plasohen komunitetit bujqësor, ose të paktën jo aq shpejt sa duhet.

Në thelb, ajo që u nevojitet fermerëve është këshilla me kohë, e përshtatur, e besueshme dhe e thjeshtë, edhe nëse nuk u nevojitet vazhdimisht, dhe nëse ndonjëherë nuk e dinë gjithmonë vlerën e saj derisa të vijë koha. Që një fermer të marrë kohë nga dita e tij është një sakrificë më e madhe se sa mund të duket. Prandaj, kur ata e bëjnë këtë për të kërkuar këshilla, kjo këshillë duhet të jetë sa më e mirë që mundet, për të shfrytëzuar sa më mirë kohën e secilit.

Organizatat e fermerëve në shumë vende vërejnë se rentabiliteti i ulët në bujqësi rezulton në faktin që pagesa për këshilla është më e ulët në listën e prioritetëve për shumë fermerë. Kjo përkeqësohet nga nevoja për të paguar për këshilla për të respektuar rregullat dhe për të plotësuar formularët. Me kaq shumë këshilla të nevojshme për të vepruar në pajtim me rregullat, ka pak kohë ose burime të mbetura për të këshilluar fermerët se si të përmirësojnë sistemet e tyre. Ata mbrojnë financimin nga qeveritë për të ndihmuar, por aktualisht kjo është e ulët në agjendat politike kombëtare/rajonale. Vëmendje e kujdesshme duhet t’i kushtohet përshtatshmërisë së këshilltarit të përfshirë. Këshillat për fermat po privatizohen gjithnjë e më shumë. Ndërsa kjo vetë mund të mos jetë e keqe, problemi është përballueshmëria; me siguri Kosova nuk është ende gati për një shërbim këshillues krejtësisht privat.

SNJIB shpesh përbëhet nga qeveritë qendrore dhe krahinore, Oda e Bujqësisë, institutet e ndryshme kërkimore duke përfshirë universitetet bujqësore, shkollat, shoqatat dhe disa OJQ janë pjesë e SNJIB-së. Ministria e Bujqësisë po merr rolin koordinues.

Grafiku – pasqyra e përgjithshme e ARKIS²



Siç është përmendur tashmë në Sistemin Këshillues të Kosovës për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2015-20, struktura dhe organizimi i mëhershëm i SKKBZHR-së mund të jetë afër asaj të re të SNJIB-së.

- 1) DSHKT/MBPZHR;
- 2) Qendrat Informative Këshilluese Komunale (QIKK) për bujqësi dhe zhvillim rural;
- 3) Ofruesit e shërbimeve këshilluese private;
- 4) Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (Agjencia e Pagesave);
- 5) Fakulteti i Bujqësisë, Universiteti i Prishtinës;
- 6) Instituti Bujqësor i Kosovës, Pejë;
- 7) Instituti i Vreshtarisë dhe Verëtarisë;
- 8) Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë e Kosovës;
- 9) Shkollat Profesionale Bujqësore;
- 10) Bizneset agro-ushqimore;
- 11) Bizneset rurale, p.sh. furnitorët e produkteve, qendrat e grumbullimit të mallrave, etj.; dhe
- 12) Fermerët dhe komuniteti rural, duke përfshirë Grupet Lokale të Veprimit.

Ky SNJIB mund të krijohet me të dhëna të konsiderueshme nga DSHKT. Koordinimi i institucioneve të ndryshme është gjithmonë i lidhur ngushtë me vendimet financiare. Me fjalë të tjera, është ministri i MBPZHR-së ai që duhet të marrë vendime dhe të koordinojë aktivitetet madhore; shumë prej tyre mund të zbatohen në punën e përditshme nga DSHKT-ja. Aktualisht DSHKT duket të jetë shumë i dobët për t'u koordinuar me institucionet e tjera shtetërore, por kur kushtet e përgjithshme caktohen nga ministri, atëherë DSHKT mund të jetë një shtytës efikas në përmirësimin e shërbimeve këshilluese përmes të gjitha organizatave partnere.

² i2connect: SNJIB dhe shërbime këshilluese në Irlandë. Raport për inventarin e SNJIB-së. 2020

7 Literatura e konsultuar

Literatura

Drejtoria e Përgjithshme e KE-së për Bujqësi dhe Zhvillim Rural: Përgatitja për të SNJIB-në e ardhshëm në Evropë; 2019

FIELDSEND, A.F.: Sistemet e Njohurive Bujqësore dhe Inovacionit në diskursin e politikave të Bashkimit Evropian: Quo vadis? Studime në Ekonominë Bujqësore 122 (2020) 115-123. 2020
<https://doi.org/10.7896/j.2055>

i2connect: SNJIB dhe shërbimet këshilluese në Austri. Raport për inventarin e SNJIB-së. 2020

i2connect: SNJIB dhe shërbimet këshilluese në Hungari. Raport për inventarin e SNJIB-së. 2020

i2connect: SNJIB dhe shërbimet këshilluese në Irlandë. Raport për inventarin e SNJIB-së. 2020

i2connect: SNJIB dhe shërbimet këshilluese në Slloveni. Raport për inventarin e SNJIB-së. 2020
MBPZHR: Sistemi Këshillues i Kosovës për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2015-20; 2015

MBPZHR: Strategjia për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022 – 2028; 2022

SWG SCAR-AKIS Përmbledhje e Politikave për të Ardhmen e Shërbimeve Këshilluese; 2017

Faqet e internetit

<https://organika-ks.org/publikime/>

<https://www.cecra.net/en/overview-of-the-modules/>

<https://www.lko.at>


https://www.researchgate.net/publication/310584299_Criteria_for_a_system_level_evaluation_of_farm_advisory_services

<https://www.trade.gov/country-commercial-guides/hungary-agricultural-sectors>

8 Shtojca - Anëtarët e Grupit Punues

- 1) Ahmet Zejnullahu - DSHKT/Departamenti i Shërbimeve Këshilluese dhe Teknike
- 2) Tahir Halitaj - DSHKT/Departamenti i Shërbimeve Këshilluese dhe Teknike
- 3) Hysen Muzliukaj - Kabineti i Ministrisë (Kabineti i Ministrave)
- 4) Bekim Cikaqi - DSHKT/Departamenti i Shërbimeve Këshilluese dhe Teknike
- 5) Hasan Sejfiqaj - DSHKT/Departamenti i Shërbimeve Këshilluese dhe Teknike
- 6) Shyhrete Bunjaku - DL/Departamenti Ligjor
- 7) Kadri Kadriaj - APK/Agjencia e Pyjeve të Kosovës
- 8) Lulzim Shamolli - DPZHR/Departamenti i Politikave të Zhvillimit Rural
- 9) Skënder Bajrami - DAE&SB/Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore
- 10) Kemajl Kadriu - DP/Departamenti i Pyjeve
- 11) Ylber Kuçin - DVV/Departamenti për Vreshtari dhe Verëtari
- 12) Arsim Memaj - DPBT/Departamenti i Politikave dhe Tregjeve Bujqësore
- 13) Zekirja Loku - AZHB/Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë
- 14) Fadil Musa – Fak. i Bujqësisë/Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë
- 15) Lamir Thaqi - AUV/Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë
- 16) Agim Zuzaku - ESG - kompani këshilluese e licencuar / Kompani Konsulente e Licencuar
- 17) Betim Bresilla- IBK/Instituti Bujqësor i Kosovës
- 18) Avdyll Feka – QIKK Vushtrri/Qendra Informative Këshilluese Komunale

9 Stojca – Organogrami i MBPZHR-së



10 Shtojca – Vërejtjet për Strategjinë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022 – 2022

Konsulenti komenton frazat përkatëse në strategjinë për bujqësi, në mënyrë që këto komente të mund të pasqyrohen në kapitullin Plani i Veprimit 2023 – 2028.

MBPZHR: Strategjia për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022 – 2022

f 17

aktivitetet këshilluese aktualisht po zbatohen dobët në Kosovë.

- Fermerët nuk marrin këshilla të mjaftueshme; nevojiten më shumë kontakte (në ferma) ndërmjet këshilltarëve dhe fermerëve

f 22

Sipas kornizës ligjore në fuqi, sistemi këshillues publik është përgjegjësi e departamentit të MBPZHR-së, i cili koordinon aktivitetet e Qendrave Informative Këshilluese Komunale.

Megjithëse relativisht i ri, sistemi këshillues privat është më i madh se sistemi publik. Veprimtaria e tij lidhet me tema specifike për interesin e fermerëve: inputet, qendrat grumbulluese, përpunimi agro-ushqimor dhe skemat e granteve. Qendrat e grumbullimit dhe fabrikat e përpunimit të ushqimit ofruan trajnime të suksesshme mbi standardet e tregut dhe ndihmën nga donatorët. Një organizatë lokale e konsoliduar me aktivitete horizontale të lidhura me bujqësinë dhe përvojë të mirë në ofrimin e trajnimeve për fermerët është IADK; megjithatë, veprimi i saj është më i orientuar drejt projektit dhe, si në rastin e mbështetjes nga donatorët, shtrohet çështja e qëndrueshmërisë afatgjatë.

- Duhet një bashkëpunim më i mirë me sistemin këshillues privat, dhe kjo do të ndodhë nëse Departamenti i Shërbimeve Këshilluese dhe Teknike do të nënkontraktojë dhe financojë shërbimet këshilluese private, si dhe do të zbatojë partneritetin publiko-privat.

(Më sipër u ra dakord në GP)

Koordinimi ndërmjet sistemeve këshilluese publike dhe private është i dobët. Një nga arsytet është mungesa e shoqatave të organizuara mirë të fermerëve që mund të përfshihen në transferimin e njohurive për

përfitim të anëtarëve të tyre. Sistemi këshillues publik nuk mund të adresojë saktë nevojat e fermerëve, pasi mbështetet në një buxhet të kufizuar dhe nuk ka një sistem monitorimi dhe vlerësimi për aktivitetin e tij. Në të njëjtën kohë, sektori privat zakonisht lidhet me biznese specifike ose ndihmon fermerët të kenë qasje në grante, ndërkohë që mungon një plan për akreditimin e ofruesve të këshillimit. Universitetet dhe institutet kërkimore janë të përfshira dobët dhe jo të orientuara nga fermerët; kryesisht mungon koncepti i inovacionit brenda transferimit të njohurive. Sistemi këshillues nuk synon kategorinë e fermerëve me potencialin më të lartë të aplikimit të njohurive të reja: fermerët e rinj, dhe gjithashtu nuk synon praktikën moderne bujqësore për mbrojtjen e tokës dhe ujit.

- ❖ Sigurisht që mungojnë shoqata (private) të organizuara mirë të fermerëve, por më e rëndësishme është që nuk ka këshilltarë. Duke pasur një buxhet prej 500,000 euro, Departamenti i Shërbimeve Këshilluese dhe Teknike mund të bëjë të paktën hapat e parë për të arritur tek fermerët.
- Nuk ka sistem monitorimi dhe vlerësimi për aktivitetet këshilluese; me fjalë të tjera, këshilltarët komunalë bëjnë atë që duan ose atë që duan kryetarët e tyre, por ndikimi i Departamenti i Shërbimeve Këshilluese dhe Teknike duket jetë shumë i kufizuar.

- Ka nevojë për një plan për akreditimin e ofruesve të këshillimit; a) si të akreditohen, mundësisht nga CECRA (si standard i BE-së) dhe b) si të përfshihen/si të merren kontrata shërbimi me pagesë?

P 24

Aftësi të dobëta të menaxhimit të fermës dhe mungesë e shërbimeve gjithëpërfshirëse këshilluese dhe trajnime të rregullta

- Fermerët nuk marrin këshilla të mjaftueshme; nevojiten më shumë kontakte (në ferma) ndërmjet këshilltarëve dhe fermerëve

P 25

Baza ligjore për shërbimet këshilluese dhe të trajnimit e kompletuar. (Ligjin Nr. 04/L-074 për Shërbimet Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural me akte nënligjore);

Është krijuar struktura organizative e shërbimeve këshilluese. Themelimi i Departamentit të Shërbimeve Këshilluese dhe Teknike (Vendimi i OPS-769/12 dhe 38 Qendrat Informative Këshilluese Komunale/QIKK-të);

Mungesa e mbështetjes për QIKK-të, me logjistikën e nevojshme dhe futjen në përdorim masiv të teknologjisë së informacionit dhe faqen e internetit të shërbimeve këshilluese;

- Në faqen internetit të MBPZHR-së, mund të shihen departamentet dhe kur hapet faqja e Departamentit të Shërbimeve Këshilluese dhe Teknike, mund të shihen vetëm detyrat, por asnjë informacion tjetër. Faqja e internetit duhet të vihet në praktikë.

Numri i konsideruar i këshilltarëve bujqësor të trajnuar dhe të certifikuar (rreth 400 këshilltarë të certifikuar publik dhe privat);

Gatishmëria e 38 QIKK-ve dhe 43 këshilltarëve publik për bujqësi dhe zhvillim rural për të bashkëpunuar me Departamenti i Shërbimeve Këshilluese dhe Teknike;

- Duket se këshilltarët publik komunal janë të zënë me detyra komunale; prandaj duket se janë të gatshëm të bashkëpunojnë me DSHKT-në, por bashkëpunimi është i kufizuar.

P 26

Mungesa e vlerësimit të programeve të trajnimit dhe shërbimeve këshilluese publike, si dhe mungesa e vlerësimit të trajnerëve;

- Mungojnë analizat e ndikimit; p.sh. a fiton fermeri më shumë para pasi merr pjesë në trajnim? Çfarë ka ndryshuar ai në fermën e tij? A po bëhen më të rëndësishme çështjet mjedisore? ...

P 27

Mungesa e buxhetit të mjaftueshëm të qeverisë për funksionimin e qëndrueshëm të Shërbimeve Këshilluese;

- ❖ DSHKT ka nevojë për 100,00 euro për stafin në kuadër të MBPZHR-së dhe funksionimin e saj; 500,000 euro të tjera janë në dispozicion. Supozohet se ka buxhet të mjaftueshëm.

Buxheti operativ i DSHKT-së nuk mund të përdoret për financimin e stafit!

P 28

Bashkëpunimi dhe koordinimi më i mirë i aktiviteteve me ofruesit/këshilltarët privatë për të zgjeruar disponueshmërinë e shërbimeve këshilluese në mbështetje të shërbimit këshillues pluralist, i cili mund të ofrohet për fermerët dhe komunitetin rural;

- Duhet një bashkëpunim më i mirë me sistemin këshillues privat, dhe kjo do të ndodhë nëse Departamenti i Shërbimeve Këshilluese dhe Teknike do të nënkontraktojë dhe financojë shërbimet këshilluese private, si dhe do të zbatojë partneritetin publiko-privat.

Mungesa e një strategjie të miratuar (në kuadër të MBPZHR-së) për shërbime këshilluese.

- Konsulenti po ndihmon Grupin Punues për të përcaktuar një të tillë; padyshim që do të ishte e dobishme të adresoheshin të gjitha mangësitë e përmendura në strategjinë bujqësore.

Rreziku i perceptimit të shërbimeve këshilluese si të padobishme nga fermerët;

- Fermerët vështirë se shohin ndonjëherë një këshilltar publik në fermën e tyre. Prandaj ky perceptim mund të jetë i vërtetë.

Mungesa e një organi certifikues/akreditues për licencimin e këshilltarëve bujqësor

- Ka nevojë për një plan për akreditimin e ofruesve të këshillimit; a) si të akreditohen, mundësisht nga CECRA (si standard i BE-së) dhe b) si të përfshihen/si të merren kontrata shërbimi me pagesë?

Mungesa e vullnetit politik në ristrukturimin dhe organizimin e Departamentit të Shërbimeve Këshilluese dhe Teknike, në një institucion arsimor, këshillues dhe kërkimor që mbështet bujqësinë e qëndrueshme.

- Ka nevojë për një orientim më të mirë të bujqësisë së qëndrueshme dhe çështjeve mjedisore.

P 33

Sistemi këshillues kishte veprime minimale për të promovuar praktika të mira mjedisore për të ruajtur burimet natyrore.

- Ka nevojë për një orientim më të mirë të bujqësisë së qëndrueshme dhe çështjeve mjedisore.

P 47

Shërbimet këshilluese ende nuk po trajtojnë saktë çështjet e biznesit rural. OJQ-të lokale (për mbrojtjen e mjedisit, fuqizimin e grave, zhvillim të qëndrueshëm, etj.) janë të burim i vlefshëm që mund të përfshihet në mënyrë efikase në zhvillimin e zonave rurale.

- Ka nevojë për një analizë të nevojave të bizneseve rurale dhe më pas trajnime të brendshme për të arritur në pozicionin për të ndihmuar në mënyrë efektive bizneset rurale. OJQ-të lokale (shoqatat, kooperativat, grupet e fermerëve) duhet të përfshihen dhe kontraktohen;

P 51

Sistemi këshillues i pazhvilluar

P 60

Në lidhje me adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike, praktikat, shërbimet këshilluese duhet të përfshihen më shumë në zhvillimin e fushatave ndërgjegjëse dhe mbajtjen e sesioneve trajnuese.

- Ka nevojë për një orientim më të mirë të bujqësisë së qëndrueshme dhe çështjeve mjedisore.

P 61

Nevoja 1.13: Forcimi i shërbimeve këshilluese dhe përfshirja e inovacionit si pjesë thelbësore e transferimit të njohurive

Me një bujqësi kryesisht dominuese në shkallë të vogël, organizatat private të konsulencës dhe fermerët nuk kanë aktualisht kapacitet për të ofruar mjete për qasje në informacion dhe inovacion për këtë kategori. Burimet njerëzore dhe financiare për këshillim duhet të pasqyrojnë këtë nevojë. Mbetet detyrë e shtetit ta bëjë këtë.

- Konsulenca private dhe organizatat e fermerëve duhet të kontraktohen nga DSHKT për t'u përfshirë në transferimin e njohurive; mundësisht ata duhet të trajnohen paraprakisht.

P 61

Kosova duhet së pari të hartojë një grup të thjeshtuar Kushteve të Mira Bujqësore dhe Mjedisore (KMBM) dhe të zhvillojë fushata ndërgjegjëse mes fermerëve me mbështetjen e sistemit këshillues publik.

- Ka nevojë për broshura, raporte në formë elektronike të prodhuara nga DSHKT

P 66

Nevoja 4.2.1.3: Konsolidimi i departamenteve të tjera të MBPZHR-së

Departamentet e tjera të MBPZHR-së që kanë nevojë urgjente për konsolidim (me personel të duhur/ekstra dhe trajnim adekuat) janë departamenti për integrim evropian, shërbime këshilluese, ujitje, bujqësi organike dhe analiza ekonomike.

- Ka nevojë për staf shtesë dhe të trajnuar mirë, i cili pjesërisht do të punësohet së shpejti në formën e 7 Koordinatorëve Rajonal. Këta koordinatorë rajonal do të "koordinojnë" punën ndërmjet stafit komunal dhe DSHKT-së dhe do të ofrojnë shërbime këshilluese në nivel ferme.
 - 7 persona për më shumë se 100,000 fermerë nuk janë të mjaftueshëm, por mund të konsiderohen si fillim. (Për arsye optike, një pasqyrë dekurajuese tregohet nëse 13 punonjës të përhershëm në MBPZHR-së organizojnë punën e 7 persona në terren. Këtu, në vend të raportit prej 2: 1, një raport prej 1: 30 duhet të parashihet; d.m.th për çdo person në MBPZHR 30 këshilltarë në terren.) Në periudhën afatmesme janë paraparë 21 këshilltarë rajonalë.
- Meqenëse stafi i MBPZHR-së paguhet më mirë se stafi komunal, do të ishte e mençur që të trajnohen të gjithë personat e interesuar për t'u bërë këshilltarë sipas DSHKT-së, të cilët më pas duhet t'i nënshtrohen një procesi certifikimi (CECRA); ata që kalojnë testin do të punësohen në MBPZHR.
- Këshilltarët në nivelin aktual komunal mund të mos jenë mjaftueshëm të kualifikuar dhe atëherë ata nuk do të mund të kalojnë në stafin e MBPZHR-së.
- Aktualisht koordinatorët e paraparë do të kenë funksion të dyfishtë; a) të harmonizojnë aktivitetet e komunës me DSHKT-në dhe b) të ofrojnë shërbime këshilluese për fermerët në terren; prandaj këta koordinatorë rajonal duhet të trajnohen dhe certifikohen.

Shërbimet këshilluese publike duhet të përgatiten për të krijuar Sistemin Këshillues të Fermave (SKF), duke vënë kështu në dispozicion informacione për fermerët dhe duke nxitur përvetësimin e praktikave të mira.

P 81

Fuqizimi i Departamentit të MBPZHR-së për Shërbime Këshilluese

Koordinimi teknik i këshilltarëve nga niveli komunal duhet të bëhet përmes transferimit të plotë administrativ të tyre në departamentin e MBPZHR-së. Përshkrimi i vendeve të punës, detyrat mujore dhe raportet do të miratohen në nivel të MBPZHR-së. Duke qenë se numri i tyre është ende i kufizuar, detyrat e tyre duhet të fillojnë me shkëmbimin e informacionit, veçanërisht për çështjet që lidhen me pagesat direkte

dhe grantet, por pa përfshirë veprimet këshilluese ose të konsulencës.

- Inkurajohet që të mbahet një takim ndërmjet Ministrit të Bujqësisë, Ministrit të Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministrit të Financave për të finalizuar transferimin e të gjithë këshilltarëve komunal për bujqësi në DSHKT; në rast se kjo nuk do të jetë e suksesshme, DSHKT do të duhet të rekrutojë stafin e vet i cili do të vendoset në nivel komunal.

(Më sipër u ra dakord në GP)

Sistemi Këshillues i Fermave i fokusuar në kushtëzimin mjedisor duhet të bëhet pjesë e përgjegjësisë të Departamentit për Shërbime Këshilluese.

- Ka nevojë për një orientim më të mirë të bujqësisë së qëndrueshme dhe çështjeve mjedisore.

P 82

Shërbime këshilluese për fermerët mbi praktikën bujqësore, kontabilitetin dhe marketingun duke marrë parasysh inovacionin

Një projekt afatgjatë (të paktën trevjeçar) i asistencës teknike i koordinuar nga departamenti i shërbimeve këshilluese do të nënshkruhet me ofruesit e shërbimeve. Përfitues do të jenë fermerët.

- Meqenëse nuk ka ofrues të kualifikuar të shërbimeve në Kosovë, mund të jetë më mirë të krijohen kapacitetet e veta brenda MBPZHR-së, veçanërisht kur këshilltarët komunalë do të jenë përfundimisht pjesë e MBPZHR-së.

11 Shtojca - Përvoja nga vende të tjera

Shërbimet këshilluese për bujqësi të disa vendeve evropiane përshkruhen këtu për të ofruar njohuri mbi strukturën e vendeve të tjera dhe për të inkurajuar anëtarët e Grupit Punues që të “mendojnë ndryshe”.

11.1 Forumi Evropian për Shërbimet Këshillimore në Bujqësi dhe Zhvillim Rural



Forum i Evropian i Shërbimeve Këshillimore për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (EUFRAS) është një shoqatë evropiane, e themeluar në vitin 2013. Qëllimi i tij është të përmirësojë shërbimet këshilluese në fermë dhe zona rurale dhe të forcojë kompetencat e këshilltarëve. Ai përfshin 31 organizata anëtare nga 21 vende.

EUFRAS është krijuar për të luajtur një rol avokues për anëtarët duke iu drejtuar veçanërisht institucioneve të BE-së në fushën e politikave bujqësore dhe zhvillimit rural. Konferencat, seminarët dhe ngjarjet ofrojnë një platformë për shkëmbim dhe bashkëpunim ndërmjet shërbimeve këshilluese nga e gjithë Evropa.

EUFRAS ka botuar EU FarmBook, një koleksion praktikash më të mira të verifikuara për fermerët dhe pylltarët. Qëllimi është të mbledhen të gjitha praktikat më të mira në një rezervuar të njohurive digjitale që është EU-FarmBook (<https://eufarmbook.eu/>). E gjithë përmbajtja në bibliotekë sigurohet nga projektet kërkimore Horizon.

EU FarmBook po zhvillohet për të testuar një ide të madhe: A mund të bashkohen dhe organizohen të gjitha rezultatet e prekshme të projekteve kërkimore dhe inovative të financuara nga BE-ja në një platformë miqësore për përdoruesit për të ndihmuar në marrjen e njohurive praktike në duart e fermerëve, pylltarëve dhe këshilltarëve në të gjithë Evropën që kanë më shumë nevojë për të? Sfidat për ta bërë këtë janë të mëdha – për t'i përmendur disa si çështjet e cilësisë dhe përputhshmërisë të (bazës) së të dhënave, barrierat gjuhësore dhe çështjet mes gjeneratave – por ne besojmë se e ardhmja e inovacionit të bujqësisë dhe pylltarisë në Evropë është digjitale dhe kërkon një rritje të madhe dhe përmirësim të shkëmbimit digjital të njohurive ndërmjet rajoneve të BE-së dhe Shteteve Anëtare, si dhe ndërmjet palëve të ndryshme të interesit në bujqësi: kërkuesve, politikëbërës, NVM-ve, këshilltarëve, fermerëve dhe pylltarëve.

11.2 Austria

Austria – konteksti dhe sfidat

Austria ka një popullsi prej 8,913,000 banorësh dhe një sipërfaqe prej 83,871 km katrorë. Ajo ka 160.000 ferma bujqësore dhe rreth 80.000 prej tyre janë ferma me orar të plotë; d.m.th nuk kanë të ardhura të tjera.

Toka bujqësore bulon 38 % të vendit; tokë e punëshme 17 %, kultura të përhershme 0,8 % dhe kullota të përhershme 21 %; pyjet mbulojnë 47 %. (Një fermë duhet të menaxhojë më shumë se 2,5 ha.)

Sipërfaqja mesatare totale për një ekonomi është 45 ha, nga të cilat 20 ha shfrytëzohen si sipërfaqe bujqësore; pjesa tjetër është kryesisht pyll privat.

Bujqësia dhe pylltaria e Austrisë po përballen me sfida të shumta:

- a) Përgatitja e planit strategjik kombëtar të PPB-së për periudhën 2023-2027 duke marrë në konsideratë kërkesat e BE-së (Marrëveshja e Gjellbër, Strategjia Farm to Fork dhe Biodiversitet)
- b) Përcjellja e kërkesave dhe kushteve të PPB-së 2023 në 2027 dhe zbatimi i tyre së bashku me fermerët përmes aktiviteteve edukative dhe këshilluese.
- c) Zbatimi i masave për mbrojtjen e klimës dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike
- d) Zhvillimi i proceseve të optimizuara për efikasitet më të mirë të energjisë
- e) Reduktimi i përdorimit të pesticideve, plehrave dhe antibiotikëve
- f) Masat për përmirësimin e mirëqenies së kafshëve
- g) Përmirësimi i pozicionit të ndërmarrjeve bujqësore dhe pyjore në zinxhirin e vlerës
- h) Masat për të siguruar zinxhirë të shkurtër furnizimi
- i) Rritja e vlerës së ushqimit rajonal
- j) Përmirësimi i konkurrencës
- k) Përmirësimi i cilësisë së ushqimit
- l) Promovimi i digjitalizimit në bujqësi dhe pylltari
- m) Zhvillimi i ofertave shpesh për edukimin dhe zgjerimin e mëtejshëm digjital (uebinare, ferminare, diskutim online) me parakushtet përkatëse (pajisjet teknike dhe trajnimi i stafit të ekstensionit dhe fermerëve), menaxhim të rrezikut ose parandalim të krizave (p.sh. ndërprerje të energjisë në stalla të kontrolluara elektronikisht, Covid-19)
- n) Reduktimi i emetimeve dhe rrjedhimisht efektit serë

Shërbimet këshilluese për bujqësi – shërbimet udhëzuese – janë pjesë e pjesë e SNJIB-së.

SNJIB

Termi Sisteme të Njohurive dhe Inovacionit në Bujqësi (SNJIB) përdoret për të përshkruar të gjithë sistemin e shkëmbimit të njohurive - mënyrat se si njerëzit dhe organizatat ndërveprojnë brenda një vendi ose rajoni - të paktën brenda BE-së. SNJIB mund të përfshijë praktikën bujqësore, bizneset, autoritetet, kërkimin shkencor, etj. dhe merr në konsideratë dimensionet teknike, organizative dhe sociale për të kapërcyer hendekun mes shkencës dhe praktikës. SNJIB bazohet në bashkëpunimin ndërmjet kërkimit, edukimit dhe ekstensionit.

Prandaj Sistemi Austriak i Njohurive dhe Inovacionit Bujqësor (SNJIB) bazohet në

- 1) arsimin dhe aftësimin profesional (VET) dhe
- 2) arsimin për të rritur.
- 3) Gama e shërbimeve orientuese në mbarë vendin dhe me cilësi të lartë dhe
- 4) mjedisi kërkimor bujqësor.

Meqenëse bujqësia dhe qëndrueshmëria e zonave rurale janë interesa publike, organet publike, Ministria e Bujqësisë (me institutet e saj mësimore dhe kërkimore), zyrat federale dhe qeveritë krahinore të nëntë krahinave, 10 Odat e Bujqësisë me 73 odat e tyre të rajoneve dhe 1700 punonjës,

institutet e ndryshme kërkimore (përfshirë universitetin bujqësor (BOKU), shkollat, shoqatat dhe disa OJQ janë pjesë e SNJIB-së.

Vetëm disa organizata janë në kontakt të drejtpërdrejtë me fermerët, në radhë të parë odat e bujqësisë, por edhe veterinerët, shoqatat e bujqësisë organike, disa shoqata të fermerëve dhe organizatat jofitimprurëse.

Kooperativat, konsulentët privatë dhe agro-industria luajnë vetëm një rol të vogël në këshillimin e fermerëve. Vetëm në fusha të veçanta (p.sh. hortikultura, kultivimi i perimeve dhe frutave, menaxhimi i tufave, marketingu, çështjet e taksave) firmat private të konsulencës luajnë një rol më të madh.


Përgjegjësitë janë përgjithësisht të përcaktuara qartë dhe të ndara ndërmjet organizatave në nivel federal dhe shtetëror. Bashkëpunimi – po ashtu i strukturuar – ndërmjet akterëve dhe rrjedha e informacionit brenda SNJIB-së është e mirë, mbivendosjet e përgjegjëseve dhe konkurrencës janë të rralla. Përshkueshmëria nga kërkimi në praktikë dhe anasjelltas në thelb funksionon mirë, edhe nëse transferimi i informacionit është i ngadalshëm dhe nuk ka shkëmbim të rregullt dhe të institucionalizuar të informacionit ndërmjet të gjithë akterëve.

SNJIB është shumë i varur nga fondet publike dhe Ministria luan rol të rëndësishëm si agjenci financuese.

Odat e Bujqësisë (LK) si ofrues kryesor i shërbimeve këshilluese

Odat e Bujqësisë – të themeluara në vitin 1922 – janë përfaqësim ligjor i interesave të fermerëve austriakë dhe organeve sipas ligjit publik të krijuara nga ligji krahinor. Ato financohen gjysmë publikisht pasi mbështeten financiarisht (kryesisht) nga krahinat dhe qeveria federale, por gjithashtu mbledhin tarifat e detyrueshme të anëtarësimit (“Kammerumlage”) nga fermerët. Ofertat këshilluese të bazuara në tarifë kontribuojnë me më pak se 10% në buxhetet e odave.

Odat e Bujqësisë ndahen në 9 Oda Rajonale të Bujqësisë me mbi 70 oda regionale ose zyre degësh, në të cilat punojnë gjithsej rreth 1700 punonjës me orar të plotë. Oda Austriake e Bujqësisë (“Präsidentenkonferenz”) është organizata ombrellë e nëntë Odave të Bujqësisë në nivel federal.



4 detyrat kryesore të Odës së Bujqësisë

- 1) Përfaqësimi i interesave të anëtarëve të saj (të gjithë fermerëve dhe pylltarëve në Austri)
- 2) Përfshirja në administrimin e fondeve (p.sh. menaxhimi i fondeve për qeverinë shtetërore dhe federale)
- 3) Këshilla për anëtarët: Mandati i detyrueshëm për të këshilluar të gjitha ndërmarrjet bujqësore dhe pyjore është përcaktuar në ligjet e shtetit. Kështu që, Oda e Bujqësisë merr rolin e këshilltarit zyrtar të Austrisë.
- 4) Trajnimi fillestar dhe i vazhdueshëm për anëtarët përmes Institutit të Trajnimit Rural (LFI, shih më poshtë). Trajnimi profesional ofrohet nga Zyra e Praktikës dhe e Punëtorëve të Aftësuar (LFA, shih më poshtë) e lidhur me Odat Rajonale të Bujqësisë.

Qëllimi është që të ketë përmes Odës së Bujqësisë një parim “të pikave të shërbimit” në fushat e këshillimit, promovimit dhe trajnimit për ndërmarrjet bujqësore dhe pyjore.

Oda e Bujqësisë është gjithashtu shtëpia e shumë shoqatave të tjera tregtare. Sjellja e tyre së bashku nën ombrellën e odës mundëson një koordinim të ngushtë dhe një rrjedhë mirë të njohurive ndërmjet elementeve qendrore të këshillimit, arsimit dhe aftësimit profesional fillestar dhe të vazhdueshëm, të cilat janë çështje kyçe për SNJIB.

Shihni edhe në <https://www.lko.at>

Në shërbimet e ekstensionit bujqësor dhe pyjor Odat e Bujqësisë janë ofruesi qendror i shërbimeve në Austri. Përveç kësaj, shërbimet këshilluese ofrohen pjesërisht edhe nga shoqatat profesionale. Në fushën e konsulencës organike, Odat e Bujqësisë punojnë së bashku me BIO Austria, shoqata më e madhe organike austriake, nën ombrellën e ARGE Bioberatung.

Ofruesit e këshillimit privat janë të përfaqësuar në nivel rajonal në tema të nxehta dhe të veçanta, por luajnë një rol vartës në SNJIB si tërësi.

Kooperativat bujqësore – që kryesisht i përkasin Raiffeisen – ofrojnë shërbime konsulence. Megjithatë, kjo është e kufizuar në sektorin specifik dhe grupet e produkteve të ofruara. Kultivuesit dhe prodhuesit e bagëtive, drithërave, frutave dhe perimeve janë të organizuar në disa dhjetëra shoqata në Austri – si BIO AUSTRIA (shoqata e fermerëve organik).

Prandaj, shërbimet këshilluese dhe mbështetëse synojnë kryesisht të ndihmojnë fermerët për të përballuar kushtet e reja të kornizës ekonomike dhe për të përshtatur sistemin e subvencioneve bujqësore me kërkesat e BE-së. Rëndësia e Odës së Bujqësisë vazhdoi të rritet kur u bashkua kur shteti ju bashkua BE-së në vitin 1995, por mbështetja publike për shërbimet këshilluese filloi të bjerë. Megjithatë, në këmbim të kësaj, financimi publik për masat e trajnimit u rrit masivisht falë financimit nga BE.

Ministria e Bujqësisë mbështet shërbimet e ekstensionit në disa mënyra, për shembull përmes kontrollit strategjik,

- 1) Marrëveshja për prioritetet e ekstensionit dhe programet e ekstensionit,
- 2) Subvencionimi për kostot e personelit të stafit të ekstensionit,
- 3) Përgatitja e dokumenteve shitesë dhe ndihmave, dhe
- 4) Trajnimi i mëtejshëm i stafit të ekstensionit në bashkëpunim me institucionet mësimore dhe kërkimore nën moa).

Mbështetja këshillimore ofrohet që nga viti 2017 nëpërmjet 2 pistave: nga fondet e programit LE 14-20 dhe, përveç kësaj, nga fondet federale kryesisht të financuara në nivel kombëtar. Për këtë qëllim, u zhvillua paraprakisht një procedurë e prokurimit publik, nga e cila një kontratë koncesioni për shërbime iu dha ARGE LK Beratung (konsorcium i të gjitha odave të bujqësisë) dhe ARGE Bioberatung (konsorcium i odave të bujqësisë dhe Bio Austria) për vitet 2017 deri në 2021.

Çdo vit, 8.5 milionë euro janë në dispozicion, nga të cilat 5.06 milionë euro vijnë nga fondet e LE (BE, Qeveria Federale, krahinat federale) dhe 3.44 milionë euro nga fondet kombëtare.

Financimi i shoqatës siç është ARGE Bioberatung është një subvencion i kostos së personelit për këshilltarët me një kualifikim specifik teknik dhe metodologjik (parakusht për financim) të cilët këshillojnë fermerët për tema të specifikuara duke përdorur metoda të specifikuara.

Katalogu i temave, i cili mbulon gjithsej njëmbëdhjetë fusha këshillimi, përfshin gjithashtu përmbajtjen e Shërbimit Këshillues të Fermave ("SHKF"), i cili parashikohet nga ligji i BE-së (shih më poshtë).

Klientë të shërbimit këshillues janë të gjithë personat që punojnë në bujqësi dhe pylltari.

- Pothuajse çdo fermer (97%) ka pasur kontakt me Odën e Bujqësisë në 2 vitet e fundit.
- 88% e fermave në kontakt me Odën e Bujqësisë kanë përdorur shërbime këshilluese.

Fokusi kryesor i këshillave dhe kontaktet më të shpeshta këshilluese janë në fushat e mëposhtme

- a) Këshilla për subvencionet kombëtare të financuara nga BE, të bashkë-financuara nga BE,
- b) Çështjet ligjore, tatimore dhe të sigurimeve shoqërore,
- c) Temat e administrimit të biznesit dhe zhvillimit të biznesit,
- d) Përmirësimi i konkurrencës (metoda të reja dhe të optimizuara të prodhimit bujqësor në të gjithë sektorët e fermës)
- e) Ndërtimi i objekteve ekonomike dhe ndërtesave operative
- f) Pylltaria dhe menaxhimi i pyjeve

Temat me interes publik siç janë ruajtja e natyrës dhe mbrojtja e mjedisit dhe çështjet ndërsektoriale si digjitalizimi zakonisht nuk merren si oferta të pavarura. Duke i përfshirë këto tema në gamën e gjerë të shërbimeve edukative dhe këshilluese, ato mund të transportohen në ofertat e teknologjisë së prodhimit ose të menaxhimit të biznesit.

Kontaktet individuale përbëjnë pjesën më të madhe të të gjitha ndërveprimeve me klientët. Këshillat jepen përmes

- 1) Bisedave telefonike dhe përgjigjeve elektronike ndaj pyetjeve,
- 2) Kontaktit të drejtpërdrejtë me fermerin në ambientet e organizatës këshilluese dhe
- 3) Vizitave në ferma me qëllim të zhvillimit të rekomandimeve specifike ose zgjidhjeve të propozuara.

Këshillimi ose ndihma në vend për zhvillimin e një strategjie të re ose diversifikimin e të ardhurave dhe produkteve janë më pak të shpeshta për shkak të burimeve të kufizuara dhe kostove të larta të përfshira.

Këshillim në grup është një metodë shumë e njohur për të arritur një numër të madh klientësh, duke u fokusuar në procesin e gjenerimit të të mësuarit dhe inovacionit nëpërmjet ndërveprimit mes akterëve të përfshirë.

Kualifikimi i stafit këshillues. Niveli i përgjithshëm i përvojës dhe trajnimit të këshilltarëve në Austri është i lartë. Shumë këshilltarë drejojnë vetë biznese - zakonisht ferma! Shumica e të gjithë këshilltarëve kanë diplomë universitare dhe kanë marrë pjesë në kurse trajnimi të paktën një herë në vit. Përveç kësaj, shumë këshilltarë kanë përfunduar një kurs universitar në këshillim dhe edukim për të rritur ose një kurs trajnimi në pedagogji bujqësore në Kolegjin e Edukimit Bujqësor dhe Mjedisor.

Kualifikimi profesional i kërkuar për promovimin e shërbimeve të orientimit dhe këshillimit është diplomë nga shkolla e lartë e bujqësisë ose për pyje (HBLFA), kolegji ose universitet.

Sistemi Këshillues i Fermave – një obligim nga BE-ja dhe i zbatuar nga Odat e Bujqësisë

BE-ja kërkon që shtetet anëtare të ofrojnë një Sistem Këshillues të Fermave (SKF). SKF i ndihmon fermerët të kuptojnë dhe të përmbushin më mirë rregullat e BE-së për mjedisin, shëndetin publik dhe të kafshëve, mirëqenien e kafshëve dhe gjendjen e mirë bujqësore dhe mjedisore (GJMBM).

Vendet e BE-së sigurojnë një ndarje të qartë ndërmjet këshillimit për fermerët dhe kontrollit të shpërndarjes së duhur të mbështetjes së të ardhurave (p.sh. skemat mbështetëse).

SKF ofron informacionin e mëposhtëm

- a) Detyrimet e ndër-përputhshmërisë në nivel ferme,
- b) Praktikë bujqësore të favorshme për mbrojtjen e klimës dhe mjedisit, duke përfshirë mirëmbajtjen e tokës bujqësore në kushte të përshtatshme për kultivim ose kullotje
- c) Programi LE 14-20 parashikon masa në nivel ferme për modernizimin e fermave, promovimin e konkurrencës, integrimin e sektorit, promovimin e inovacionit, orientimin në treg dhe inkurajimin e sipërmarrjes
- d) Kërkesat në nivel të përfituesve, të përcaktuara në programin e veprimit të nitrarit dhe planin kombëtar të menaxhimit të ujit
- e) Parimet e përgjithshme të menaxhimit të integruar të dëmtuesve të zbatueshëm për përfituesit
- f) Kërkesat minimale për përdorimin e plehrave dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve të përcaktuara në programin LE 14-20

Në Austri, shërbimet e SKF-së janë në dispozicion për të gjithë fermerët (kryesisht) pa pagesë; në Austri është përfshirë në kontratën e konsulencës ndërmjet Ministrisë dhe Odave të Bujqësisë dhe që nga viti 2017, BE bashkëfinancon SKF-në.

11.3 Sllovenia

Sllovenia – konteksti dhe sfidat

Sllovenia ka një popullsi prej 2,101,000 banorësh dhe një sipërfaqe prej 20.273 km². Në Slloveni ka 70,063 ekonomi bujqësore me një numër në rënie të ekonomive bujqësore – si pothuajse kudo

në BE. Ekonomitë bujqësore në Slloveni përdorin 898,365 hektarë tokë, afërsisht 53% e tokës është sipërfaqe bujqësore e shfrytëzuar, rreth 44% është pyll, 2% është sipërfaqe bujqësore e pashfrytëzuar dhe 2% tokë djerrë.

Një fermë mesatare bujqësore në Slloveni përdor 3,91 hektarë tokë me bar të përhershëm dhe 2,51 hektarë tokë të punueshme. Rrjedhimisht, prodhimi bujqësor në Slloveni zhvillohet kryesisht në ferma të vogla. Për të tejkaluar madhësinë e kufizuar, 80% e fermave bujqësore rrisin kafshë. Gjithashtu frutikultura dhe vreshtaria është mjaft e avancuar. Struktura demografike dhe arsimore e menaxherëve të fermave paraqet një sfidë: 30% e tyre janë mbi 65 vjeç dhe vetëm 1.3% e menaxherëve të fermave kanë përfunduar studimet për agronomi në nivel universitar. Dhe një çështje tjetër e rëndësishme është se fermat e vogla familjare kanë një orientim të ulët të tregut.

SNJIB në Slloveni

Struktura e institucioneve që formojnë shërbime këshilluese brenda Sistemit të Njohurive dhe Inovacionit Bujqësor (SNJIB) në Slloveni është e larmishme. Ajo mund të klasifikohet në gjashtë grupe sipas qëllimit dhe kontributit të tyre në bujqësi. Tri grupet e para përbëhen nga

- 1) Sektori publik me Ministrinë e Bujqësisë dhe organet përkatëse,
- 2) 18 institucione kërkimore dhe arsimore dhe
- 3) Grupi i institucioneve publike që ofrojnë shërbime publike.


Më pas, tri grupe janë institucione private të drejtuara nga interesi që përbëhet nga

- 4) Organizatat me bazë fermerësh,
- 5) Organizatat private këshilluese dhe kompanitë dhe
- 6) OJQ-të.

Ministria e Bujqësisë dhe Mjedisit - si organ qeveritar - është përgjegjëse për bujqësinë. Shërbimet publike në bujqësi zbatohen nga organizata të ndryshme publike dhe private, si Oda e Bujqësisë dhe Pylltarisë së Sllovenisë (OBPS) dhe Shërbimi Pyjor Slloven.

OBPS përfaqëson fermerët dhe pronarët e pyjeve. Anëtarësimi për fermerët dhe pronarët e pyjeve në OBPS është ende i detyrueshëm. Përveç përfaqësimit të interesave të anëtarëve, OBPS bashkë-themloi 8 institute bujqësore dhe pyjore dhe ofron Shërbime Këshillues të Fermave (SKF) si dhe aktivitete të tjera, siç janë kërkimi, zbatimi i shërbimeve të interesave kombëtare, trajnimet, seminarët dhe aktivitetet promovuese.

Një grup tjetër i organizatave me bazë fermerësh, bazuar në anëtarësimin vullnetar, është Shoqata e Kooperativës së Sllovenisë me 73 anëtarë.



Shoqatat gjithashtu luajnë rol të rëndësishëm në sektorin e bujqësisë dhe të përpunimit të ushqimit (p.sh. prodhuesit e produkteve ushqimore të mbrojtura brenda BE-së ose skemave kombëtare të cilësisë së ushqimit, eko produkteve, prodhuesit e vegjël të djatharëve, rritësit e dhive dhe deleve, etj.). Shumica e tyre janë organizata/shoqata jo-tregtare dhe fushëveprimi i tyre i aktiviteteve për anëtarët ndryshon, megjithëse të gjitha ofrojnë mbështetje teknike, organizojnë aktivitete dhe ngjarje promovuese etj.

Këshilltarët profesionist privat përballen me një treg të vogël për shërbime këshilluese private në Sllovenia, kryesisht për shkak të OBPS-së. Konsulentët privat po ofrojnë ndihmë për grupe të ndryshme prodhuesish me fokus kryesor në marketing dhe organizim; si dhe disa veterinerë ofrojnë mbështetje për fermerët në çështjet bazë të bujqësisë.

Transferimi i njohurive dhe inovacionit nga institucionet kërkimore përmes SKF-së dhe organizatave të interesit të përdoruesi fundor, fermeri, është i ulët dhe i pamjaftueshëm. Ka disa arsye për mungesën e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve. Një nga çështjet kryesore është sistemi kërkimor i cili promovon kërkimin bazë. Kërkuesit nuk janë të stimuluar të bëjnë kërkime të aplikuara.

Të gjitha shërbimet publike financohen kryesisht nga buxheti dhe organizohen në të gjithë vendin, por problemi është se njohuritë nuk arrijnë deri te përdoruesi fundor, fermeri apo pronari i pyjeve

në masën e duhur. Shërbimet bazë të konsulencës për fusha të ndryshme të prodhimit bujqësor ofrohen nga këshilltarët bujqësor në terren të shërbimit këshillues publik. Megjithatë, mungojnë shërbimet e specializuara të këshillimit në fushën e teknologjive më të reja, në ekonominë e prodhimit, në mbrojtjen e burimeve natyrore dhe ndryshimet klimatike.

Këshilltarët janë relativisht pak të arsimuar jashtë vendit dhe zakonisht japin këshilla për ndonjë ndërhyrje/masë individuale, rrallë duke iu drejtuar fermës në tërësi.

Konsulentët privat bujqësor këshillojnë në fushat e paraqitjes së aplikacioneve kolektive, përgatitjes së planeve afariste, marrjes së burimeve të jashtme financiare, makinerive bujqësore dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve, dhe këta konsulentë shpesh janë edhe përfaqësues të ofruesve të makinerive bujqësore, plehrave etj. - Konsulentët privatë nuk janë përfshirë në SNJIB-së.

Dhomat e Bujqësisë (OBPS/KGZS – në gjuhën sllovene) si ofruesi kryesor i shërbimeve këshilluese

Shërbimi këshillues për bujqësi është një organ publik në varësi të Dhomës së Bujqësisë dhe Pylltarisë. Në vitin 1992, SKF u organizua si administratë publike në kuadër të ministrisë për fushën e bujqësisë. OBPS u krijua për të përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e bujqësisë, pylltarisë dhe peshkimit. Edhe institutet e tjera rajonale, personat juridik zyrtarisht të pavarur u bënë pjesë e Strukturës së saj organizative dhe kështu të gjitha llojet e ndryshme të këshilltarëve u bashkuan në OBPS.

Sot, OBPS është organizata ombrellë e interesit e personave fizik dhe juridik në Republikën e Sllovenisë të angazhuar në bujqësi, pylltari dhe peshkim. Detyra e saj kryesore është të mbrojë dhe përfaqësojë interesat e tyre, t'i konsultojë ata dhe të përshpejtojë aktivitetet ekonomike dhe miqësore me mjedisin. Detyrat e saj preferenciale janë përshpejtimi i zhvillimit dhe përmirësimi i kushteve ekonomike, sigurimi i funksionimit të shërbimeve të specializuara, bashkë-formimi i legjislacionit, përmirësimi i kushteve sociale të jetës, ruajtja e vendbanimeve të zonave rurale sllovene dhe promovimi bujqësisë sllovene brenda dhe jashtë vendit. Shërbimet e saj të specializuara janë shërbime këshilluese për bujqësi, përzgjedhja dhe monitorimi i prodhimit në blegtori, shërbimet këshilluese për pyje dhe qendrat për frutikulturë dhe fidanishte.

OBPS operon në tri nivele. Niveli i parë është Selia e Odës në Lubjanë, niveli i dytë përbëhet nga 13 filiale të rretheve të themeluara në tërë Slloveninë dhe 59 njësi lokale që operojnë në nivel lokal (të tretë). Një strukturë e tillë organizative e ndarë ofron shërbime të qasshme në çdo pjesë të vendit.

Shërbimet bazë të konsulencës për fusha të ndryshme të prodhimit bujqësor ofrohen nga këshilltarët bujqësor në terren. Këshilltarët e specializuar punojnë në fushat e zhvillimit rural, aktivitetet plotësuese në fermë dhe mbrojtjen e natyrës dhe mjedisit. Ka specialistë të sektorit të rritjes së bimëve, përpunimit të mishit dhe turizmit në fermë, akuakulturës, makinerive bujqësore, përpunimit të frutave në pemë frutore, përpunimit dhe prodhimit të bimëve dhe përpunimit të qumështit.

Sistemi Këshillues i Fermave – një obligim nga BE-ja dhe i zbatuar nga Odat e Bujqësisë

SKF financohet nga burime të ndryshme sipas planit vjetor të shërbimeve të miratuar nga ministria. Ndonëse pjesa më e madhe e fondeve sigurohet nga fondet kombëtare, megjithatë pjesa e saj dhe

shuma totale për shërbime publike po zvogëlohet gradualisht. Vëllimi i fondeve publike të ndara nga ministria për funksionimin e SKF-së (përfshirë bletarinë) tregon tani një buxhet prej 9.71 milionë euro.

“SKF u ofrohet të gjitha llojeve të fermerëve dhe pronarëve të pyjeve. Metodat e përdorura nga SKF janë të gjitha tipike/klasike, prandaj ato përdorin: këshilla një për një në fermë, këshilla një për një jashtë fermës, këshilla për grupe të vogla në fermë (udhëtime studimore për një grup të caktuar ndërsektorial), dhe këshilla për grupe të vogla jashtë fermave, manuale dhe broshura të shtypura (Manuali për përmbushjen e kërkesave të ndër-përputhshmërisë, katalogu i llogaritjeve për planifikimin e menaxhimit në fermat në Slloveni, bujqësia organike, listat teknologjike, etj.). Fermerët gjithashtu mund të kontaktojnë këshilltarin ose specialistin përmes telefonit ose e-mail. Sa i përket përdorimit të opsioneve të internetit, ato vendosen thjesht. Në faqen e tyre të internetit mund të gjeni informacionin e kontaktit të tyre dhe informacionin mbi seminarët dhe ngjarjet, megjithëse vetëm disa udhëzime, rekomandime dhe broshura bazë të ekspertëve janë të disponueshëm aty.

Fusha e këshillimit për bujqësi, e cila disponohet lirshëm në treg, nuk është e rregulluar as nga forma organizative ligjore, as nga njohuritë apo referenca e nevojshme.

Programi Vjetor i Aktiviteteve dhe Plani Financiar i SKF-së është konfirmuar edhe nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ushqimit. Në programin për vitin 2020 janë përcaktuar këto detyra me prioritet:

- Këshillat në fushën teknologjike, ekonomike dhe mjedisore të veprimtarisë bujqësore,
- Këshillimi dhe asistimi në zbatimin e masave të politikës bujqësore; konsultimi dhe mbështetja për zbatimin e masave bujqësore
- Këshillat dhe ndihma në organizimin dhe funksionimin e organizatave të mbarështimit, organizatave të prodhuesve dhe formave të tjera të shoqatave të prodhimit të prodhuesve bujqësor
- Këshillat në fushën e rregulloreve bujqësore dhe bujqësore,
- Menaxhimi dhe koordinimi i punës,
- Bashkëpunimi me ministrinë e tjera dhe ofruesit e shërbimeve të tjera publike, zhvillimi dhe detyrat profesionale ose puna kërkimore, dhe me organizatat, puna e të cilave lidhet me konsultimin publik

Plani i punës së këshilltarëve bazohet në programin vjetor dhe koordinohet nga OBPS në Lubjanë. Procedurat për raportim janë uniforme dhe të përcaktuara në protokoll. Këshilltarët paraqesin raport me formularë të posaçëm në versionin elektronik, i cili është i arkivuar për statistikat e tyre dhe është i paqasshëm për sistemin e kontrollit.

SKF operon në kuadër të departamenteve këshilluese për bujqësi në 8 institute bujqësore dhe pyjore, megjithëse fermerët gjithashtu mund të marrin mbështetje në 53 njësi lokale në tërë Slloveninë. Gjithsej më shumë se 300 këshilltarë janë duke punuar në OBPS.

Konsultimi brenda SKF-së është kryesisht falas për përdoruesit. Fermerët më të suksesshëm janë të gatshëm të paguajnë për këshilla të mira!

Certifikata e Konsulentëve Evropianë në Zonat Rurale është standard i ri për këshilltarët. Sllovenia nuk përdor më modelin për licencimin e këshilltarëve si në të kaluarën (pas vitit 2015 nuk i

dërgojnë këshilltarët e tyre për atë lloj licencimi = kurs 14 ditor i përgatitur nga fakulteti). Arsyeja është se ministria nuk e përdor dallimin ndërmjet këshilltarëve të licencuar apo të tjerëve për proceset e prokurimit publik në kuadër të masave të zhvillimit rural. Sot, Sllovenia përdor sistemin CECRA. CECRA është standardi evropian për trajnimin metodologjik të konsulentëve për bujqësi në zonat rurale. CECRA (Certifikata e Konsulentëve Evropian në Zonat Rurale) është një certifikatë që demonstroi kompetencën e duhur të konsulentëve për bujqësi për të këshilluar fermerat dhe zonat rurale. Ajo merret nga konsulentë që marrin pjesë në trajnime në kuadër të një programi të hartuar ndërkombëtarisht, ku fitojnë aftësi të reja metodologjike dhe aftësi shtesë komunikimi dhe trajnohen për të punuar me të ashtuquajturën teknologji të përshtatshme dhe të dëshmuar. Konsulentët që përfundojnë me sukses trajnimin janë të krahasueshëm në trajnim me konsulentët për bujqësi kudo në Evropë. Programi i trajnimit është hartuar në formën e moduleve. Shih gjithashtu në: <https://www.cecra.net/en/overview-of-the-modules/>.

Trajnimi i CECRA ofrohet vetëm në institucione të akredituara në disa vende evropiane dhe programi i trajnimit për konsulentë kryhet nga trajnerë të arsimuar të CECRA-së. Përfaqësuesi rajonal i akredituar i Programit Evropian të Arsimit CECRA në Slloveni është Oda e Bujqësisë e Sllovenisë. Vendimi për të futur standardin CECRA në këshillat për bujqësi u mor për të garantuar se konsulentët e tyre për bujqësi janë të krahasueshëm me konsulentët bujqësi kudo në Evropë dhe se cilësia dhe efikasiteti i këshillave për bujqësi në fermerat sllovene do të rritet.

11.4 Hungaria

Hungaria – konteksti dhe sfidat

Hungaria mbulon një sipërfaqe prej 93,030 km katrorë dhe ka një popullsi prej 9.937 milion banorësh. Toka e punueshme dhe kulturat e përhershme përbëjnë 45,000 km katrorë, nga të cilat rreth 1010 km katrorë janë të ujitur.³ Kullotat zënë 8000 km katrorë dhe pyjet për 19,000 km katrorë. Të korrat kryesore përfshijnë grurin (0.9 milion ha), misrin (1 milion ha) dhe farat vajore - kryesisht luledielli dhe kolzën (0.9 milion ha). Vendi ka gjithashtu një traditë të gjatë në prodhimin e farërave për mbjellje dhe produkteve të kopshtarisë. Rritja e kafshëve përfshin 2.9 milionë derra dhe një tufë shpendësh prej 39 milionë zogjsh. Numri i gjedheve të të gjitha llojeve është afërsisht 933.000 krerë.

Ka rreth 500,000 ferma bujqësore në Hungari. Me rënien e numrit të fermave dhe rritjen e tokës bujqësore, madhësia mesatare e fermave u rrit: pothuajse u dyfishua, nga 4.7 ha për fermë në vitin 2000 në 8 ha në vitin 2010. Ekonomitë bujqësore paraqesin dy klasa kryesore: ekonomitë e vogla me më pak se 2 hektarë sipërfaqe bujqësore dhe fermerat me 50 hektarë ose më shumë tokë bujqësore. Pavarësisht nga fakti se katër nga pesë prona (455 530) në Hungari bëjnë pjesë në këtë kategori, pronat me më pak se 2 hektarë të UAA-së u gjetën se mbulonin vetëm 3% të tokës bujqësore hungareze. Në anën tjetër të shkallës, fermerat me 50 hektarë tokë bujqësore ose më shumë përfaqësonin 2% margjinale të të gjitha fermave, por u zbulua se përbënin 75% të tokës bujqësore të vendit.

SNJIB në Hungari

SNJIB hungarez ka një strukturë mjaft heterogjene. Përveç ministrive të ndryshme, akterët në sistemin këshillues, pjesëmarrësit në arsim dhe kërkime, odat profesionale, organizatat e avokimit, organizatat e fermerëve, mediat dhe kanalet e informimit, OJQ-të dhe rrjetet e ndryshme të BE-

³ <https://www.trade.gov/country-commercial-guides/hungary-agricultural-sectors>

së luajnë një rol vendimtar. Oda Hungareze e Bujqësisë luan rol kyç në SNJIB dhe shërbimet këshilluese organizohen nga Qendra Kombëtare Këshillues (OSzK). Qendra Këshilluese Kombëtare koordinon, regjistron dhe kontrollon Sistemin Hungarez Këshillues të Fermave. Ajo është përgjegjëse për detyrat e mëposhtme:

- Mban listën e këshilltarëve për bujqësi dhe zhvillim rural,
- Organizon trajnimin fillestar dhe provimin e këshilltarëve;
- Kryen detyra lidhur me vlerësimin e punës së këshilltarëve dhe organizatave këshilluese;
- Kryen detyra sekretarie për komitetin këshillues kombëtar të bujqësisë,
- Operon sistemin elektronik të integruar që mbështet funksionimin e Sistemit Këshillues të Fermës,
- Kryen detyra koordinuese në lidhje me aktivitetet këshilluese dhe krijon, mirëmban dhe publikon listën e këshilltarëve dhe organizatave këshilluese,
- Mban kontakte me organizatat këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian,
- Ofron përfaqësim ndërkombëtar të sistemit këshillues hungarez të bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Oda e Bujqësisë (NAK) - si ofrues kryesor i shërbimeve këshilluese

Dhoma Hungareze e Bujqësisë (NAK) është ofruesi kryesor i shërbimeve këshilluese në Hungari. Anëtarësimi në odë është i detyrueshëm për të gjithë fermerët dhe palët e tjera të interesit. Oda luan rol të rëndësishëm në transferimin e njohurive, ndër të tjera, duke organizuar trajnimin dhe provimin e këshilltarëve, etj.

NAK është themeluar në vitin 2013 dhe aktualisht punëson rreth 1200 persona në mbarë vendin, duke përfshirë 610 agronomë fshati, të cilët, ndër të tjera, ofrojnë informacione dhe ndihmojnë anëtarët e odës në çështjet që ndërlidhen me aktivitetet e tyre. NAK mbulon dhe përfaqëson akterët në të gjithë sektorin agro-ushqimor; anëtarësimi është i detyrueshëm për fermerët, përpunuesit e ushqimit, tregtarët dhe ofruesit e shërbimeve – pra gjithsej 400,000 anëtarë.

Qendra Kombëtare e Koordinimit të Qendrave Këshilluese (OSzK) luan rol koordinues, regjistruar dhe kontrollues në kuadër të Sistemit Hungarez Këshillues të Fermave (SKF), i cili është i përshtatshëm për financimin e EAFRD-së. OSzK është pjesë e dhomës dhe operon brenda odës por me status të pavarur. Detyrat e saj kryesore janë: regjistrimi dhe trajnimi i këshilltarëve (1100 persona), si dhe ndërlidhja me akterët tjerë përkatës të NJIB-së (p.sh. Rrjeti Kombëtar i Zhvillimit Rural). NAK është përgjegjëse për aftësimin profesional agrou-ushqimor, regjistron dhe koordinon studentët dhe fermat që marrin pjesë në trajnime të dyfishta, koordinon organizimin e konkurseve studimore, merr pjesë në organizimin e kurseve dhe provimeve të Masterit, si dhe në promovimin e profesioneve agro-ushqimore.

OSzK ka 7 qendra këshilluese rajonale dhe 51 territoriale; në qendrat territoriale konsulentët e kontraktuar këshillojnë fermerët. Regjistrimi si konsulent është i detyrueshëm për personat fizik dhe organizatat që merren me veprimtari këshilluese; jo vetëm këshilltarët e pavarur janë pjesë e sistemit, por edhe ata që kryejnë shërbime këshilluese për interesa komerciale. Rreth 1,100 këshilltarë ofrojnë shërbime këshilluese në Hungari dhe luajnë rol shumë të rëndësishëm në arritjen e mbështetjes së Politikës së Përbashkët Bujqësore (PPB) dhe pajtueshmërinë me kërkesat mjedisore dhe administrative.

Ka nevojë të madhe për këtë lloj shërbimi, pasi fermerët jo gjithmonë kanë njohuri për kryerjen e detyrave administrative dhe për shkak të ngarkesës administrative, ata do të linin punën, dhe ka zona në vend ku edhe aftësitë e fermerëve në TI duhet përmirësuar.

Në lidhje me shërbimet këshilluese, ka një kërkesë në rritje - përveç të gjitha programeve mbështetëse - për këshilla teknologjike (teknologji të reja, mjete bujqësore precize, zgjidhje bujqësore organike, menaxhim të integruar të dëmtuesve, përmirësim të ujitjes). Këshilltarët dhe organizatat këshilluese

funksionojnë në Hungari si një rrjet ku fermerët më të vërtetë mund të mbështeten. Është e nevojshme të theksohet

këtu se ndërmarrjet e mesme dhe fermat më të mëdha kanë këshilltarët e tyre të punësuar.

Shërbimi i posaçëm këshillues teknologjik kryhet nga disa, zakonisht individë apo kompani të huaja. Këto përdoren nga ferma të veçanta të shkallës së mesme ose të madhe, ato që vërtet kanë nevojë për ekspertizë individuale (p.sh. një këshilltar francez për prodhimin e djathit, një italian për prodhimin e verës ose një holandez për prodhimin e luleshtrydheve).

Organizatat profesionale dhe ndër-profesionale

Ka një numër organizatash profesionale dhe ndër-profesionale në Hungari që fokusohen në nevojat e një sektori të caktuar dhe përfaqësojnë grupin e caktuar para politikëbërësve përmes avokimit, informojnë konsumatorët për ngjarjet aktuale përmes promovimit dhe ofrojnë informacion, njohuri dhe shërbime të tjera për fermerët në sektor.

Një shembull i mirë i kësaj është Organizata Ndër-profesionale e Frutave dhe Perimeve dhe Këshilli i Produkteve Hungareze (Fruitveb). Organizata organizon rregullisht ditët profesionale – edhe në gjuhë të huaja – duke u fokusuar në një temë specifike, si dhe zhvillon anketa, hulumton mundësitë

e tregut, jep këshilla, ofron trajnime mbështetëse dhe lidh fermerët. Një shembull tjetër i mirë është Shoqata Hungareze e Rritësve të Deleve Dhe dhive dhe ajo e Rritësve të Charolais (gjedhe). Shoqatat e tilla janë shumë të dobishme në informimin e rregullt të anëtarëve të tyre si për çështjet rregullatore ashtu edhe për ato teknologjike.

12 Shtojca – Rekomandimet për aktivitete të mëtejshme të donatorëve

Mangësitë në shërbimet këshilluese në Kosovë janë shtjelluar në këtë raport dhe DSHKT ka zhvilluar një matricë të veprimeve të ardhshme; duke qenë se jo të gjitha mangësitë e nevojshme janë trajtuar në detaje, pasi që padyshim nuk konsiderohen si prioritet, konsulenti rekomandon disa aktivitete të mëtejshme. Këto aktivitete mund të kenë nevojë për mbështetje nga donatorët dhe mund të përmbliidhen si në vijim.

12.1 Përgatitja për SNJIB-në e ardhshëm

Përgatitja e një pakete të plotë (grup aktivitete) për të përmbushur të gjitha kërkesat e SNJIB-së së ardhshme; që duhet të përfshijë një krahasim të asaj që nevojitet dhe asaj që është ende në dispozicion. Detyrat kryesore do të jenë që të sjellin palët e interesit në një mirëkuptim të përbashkët dhe bazuar në atë në një organizim të organizatës duke përfshirë kërkesat përkatëse financiare nga Qeveria e Kosovës:

12.2 Trajnimi efikas për këshilltarët privat që synojnë të punojnë për DSHKT-në

Vlerësimi i Nevojave për Trajnim (VNT) për të mësuar se cilat aftësi mungojnë në nivelin e kandidatëve të mundshëm dhe cilat aftësi, teknika dhe njohuri kërkohen nga fermerët dhe palët e tjera të interesit.

Sigurimi i moduleve specifike të trajnimit, bazuar në VNT; p.sh. llogaritjet financiare,

DSHKT është duke inkorporuar partneritetin publiko-privat pasi është i vetëdijshëm se DSHKT nuk mund të mbulojë të gjitha çështjet teknike dhe ekonomike, të cilat u nevojiten fermerëve dhe palëve të tjera të interesit. Prandaj DSHKT do të duhet të nënkontraktojë aktivitetet, për të cilat ende nuk është përgatitur mirë. Ky aktivitet mund të mbushë boshllëkun e theksuar

12.3 Menaxhimi i tokës dhe bujqësia e qëndrueshme dhe trajnimi specifik përkatës

Ndryshimet klimatike do të bëhen gjithnjë e më shumë problem për ndërmarrjet bujqësore dhe rurale, duke përfshirë pylltarinë dhe përpunimin e lëndës drusore, dhe për këtë arsye do të jetë thelbësore për të rritur qëndrueshmërinë e bimëve përmes bujqësisë dhe pylltarisë së qëndrueshme dhe menaxhimit të ndërlidhur të tokës, pasi që toka do të jetë baza për të gjitha bimët dhe duhet të forcohet. Kjo temë mund të shtjellohet më tej në menaxhimin e karbonit, izolimin e CO₂ dhe certifikatat përkatëse.

12.4 Mjedisi dhe toka bujqësore: bilanci i azotit

Humbjet e azotit nga toka bujqësore në mjedis, të shprehura si bilanci i azotit, në shumë vende janë ende shumë të larta. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të menaxhuar në mënyrë të qëndrueshme ciklin e lëndëve ushqyese për azotin – gjithashtu në lidhje me anëtarësimin e ardhshëm në BE.

Kjo ndotje me lëndë ushqyese rezulton gjithashtu në humbje ekonomike dhe rritje të kostove për shoqërinë (p.sh. në lidhje me trajtimin e ujit të pijshëm, shëndetin e njerëzve, turizmin dhe rekreacionin). Nëse nuk aplikohen siç duhet (p.sh. duke marrë parasysh kushtet e motit, fazën e rritjes së të korrave, dozimin), plehrat çojnë në tepëri të lëndëve ushqyese që mund të lirohen në mjedisin më të gjerë, për shembull nga rrjedhja në ujërat sipërfaqësore ose nga kullimi në ujërat nëntokësore. Eutrofikimi i shkaktuar nga lëndët ushqyese të tepërta mund të rezultojë në rritje të barërave të këqija dhe algave, ulje të niveleve të oksigjenit dhe humbje pasuese të biodiversitetit. Këto ndikime mund të zvogëlohen duke balancuar inputet e lëndëve ushqyese me rezultatet e sistemit bujqësor (d.m.th. lëndët ushqyese që gjenden në kulturat e kulltura dhe të korrura/livadhe dhe në mbetjet e bimëve) në veçanti, për të kufizuar humbjet e lëndëve ushqyese në mjedis. Kjo përmbledhje fokusohet në azotin, i cili është një element kyç në lidhje me menaxhimin e ciklit të lëndëve ushqyese në mënyrë më të qëndrueshme - është një nga elementët kryesorë të shumë plehrave. Prandaj, ka nevojë për një kuptim më të mirë të ciklit të azotit, i lidhur me regjistrimin e thjeshtë dhe me trajnimin e fermerëve për të reduktuar këto humbje të lëndëve ushqyese.

12.5 Digjitalizimi në bujqësi dhe trajnimet specifike përkatëse

Digjitalizimi do të jetë një nga kërkesat më të mëdha për aktivitetet e ardhshme rurale, duke përfshirë bujqësinë dhe pylltarinë. Këshilltarët aktualë publik, fermerët dhe palët e tjera të interesi nuk janë të njohur me këtë temë dhe për këtë arsye ajo ka nevojë për trajnime, veçanërisht Trajnim të Trajnerëve (TT); të gjithë trajnerët e ardhshëm të interesuar dhe potencialisht të certifikuar konsiderohen si grup i synuar.

Këndvështrimi

Nuk rekomandohet sigurimi i pajisjeve teknike. Gjithashtu nuk rekomandohet mbështetja e DSHKT-së në rast se nuk sqarohet përfundimisht se kush i punëson këshilltarët komunalë. Sapo të transferohen sipas DSHKT, d.m.th duke qenë aty në listën e pagave, mund të fillojë një trajnim thelbësor veçanërisht për shërbimet këshilluese publike.

Mund të përkrahet ofrimi i ndërmjetësimit për DSHKT/MBPZHR dhe nivelin komunal për transferimin nga niveli komunal në atë qendror; kjo do të kërkojë shumë takime, veçanërisht në nivel ministrie, ndërmjet palëve të interesit, siç janë Ministria e Financave, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe MBPZHR.